

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 242, Dhjetor 2023

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Gëzuar

Shoqata Atdhetare

"Dukagjini"

**ju uron KRISHTLINDJEN
dhe VITIN E RI**

2024

AT' DONAT KURTI (1903-1983) “VJOLLCA E LETRAVE SHQIPE”

KONFERENCË SHKENCORE NË 120-VJETORIN E LINDJES SË AT' DONAT KURTI.

Ditën e shtunë, më datë 9 nëntor 2023, në ambientet e Kuvendit Françeskan, në Gjuhadol dhe Bibliotekës Françeskane “At’ Gjergj Fishta” është përkujtuar 120- vjetori i lindjes së At’ Donat Kurtit, që përkon edhe me 40-vjetorin e vdekjes së tij. Në kujtim të jetës dhe veprës së At’ Donat Kurtit, Provinca Françeskane Shqiptare, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, përkatësisht Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamentet e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, si dhe Qendra e Studimeve Albanologjike Shqiptare, organizuan Konferencën shkencore AT’ DONAT KURTI (1903-1983) “VJOLLCA E LETRAVE SHQIPE”.

Konferenca u parapri nga një ekspozitë e pasur me një sërë dorëshkrimesh origjinale, si dhe 7 vëllime të reja të prezantuar për herë të parë për të pranishmit, të botuara enkas për këtë rast. Në veprat e tij, At’ Donat Kurti, ka një pasuri të jashtëzakonshme kombëtare, pasi në to Ai ka dokumentuar të gjitha traditat, doket, mitologjinë, lojërat dhe jetën shoqërore të malësive të Veriut.

Fjalën e rastit e mbajti moderatorja Shqipe Marku, përgjegjëse e Bibliotekës “At’ Gjergj Fishta”, e cila prezantoi edhe ecurinë dhe rëndësinë e kësaj konference.

Përhëndetën dhe dëshmuuan mbi jetën dhe veprën e At’ Donat Kurtit, Arqipeshkvi i Shkodrës, Monsinjor Anxhelo Massafra, Provinciali Pashko Goçaj, Zv. Rektorja e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Pavlina Hoti dhe Frat Viktor Demaj, i cili ndër të tjera falënderoi pjesëmarrësit, studiuesit dhe të gjithë ata që bashkëpunuan në realizimin e kësaj konference shkencore, dhe botimin e vëllimeve të At’ Donat Kurtit.

Për Albanologjinë Shqiptare, At’ Viktor Demaj theksoi se, studimet folkloristike dhe etnografike të Donat Kurtit, nëse studiohen dhe vlerësohen sa duhet, i shtojnë vlera turizmit në Veri të Shqipërisë.

E pranishme ishte edhe mbesa e At’ Donat Kurtit, e cila në rrëfenjat e saj kujtonte momentin kur daja i saj u arrestua me akuzën për futjen e armëve në kishë.

Në mënyrë simbolike u këndua kënga “Sa herë mue zemra m’ çohet peshë” në Bas-bariton nga Lukë Mllugja, Lutja që At’ Donat Kurti e shkruajti n’ derë të qelisë së burgut.

Konferenca ishte e ndarë në dy seanca, duke i dhënë kështu vlerësim në aspektin gjuhësor dhe letrar. Seanca e parë e gjuhësisë u zhvillua në AUDITORIN IL-LYRICUM, ku drejtuan seancën: Prof. dr. Aljula Jubani, Prof. as. dr. Orjeta Baja, Prof. dr. Artan Haxhi dhe Prof. dr. Alfred Çapaliku, i cili u paraqitën me kumtesën, me teme: “At’ Donat Kurti dijetar i Kombit”.

Prof. as. dr. Orjeta Baja dhe Dr. At’ Viktor Demaj, në kumtesën e tyre paraqitën:



Vëzhgime filozofiko dhe gjuhësore të veprës “Në rrugën e plepave” të At’ Donat Kurtit.

Po kështu kumtuuan Prof. dr. Aljula Jubani me temat: “At’ Donat Kurti, martiri i “kangëve në lavd të komit”.

Prof. dr. Mimoza Priku, Vitaliteti etnogjuhësor përmes veprës “Në rrugën e plepave” të At’ Donat Kurtit O.F.M.

Prof. as. dr. Evalda Paci, “At’ Donat Kurti O.F.M. në një dimension mjeshëtor të shqipërujesit të tekstit biblik”.

Prof. as. dr. Majlinda Bregasi “365 rrëfime nga viti 1977 prej një barakeje të Shkodrës”. Kujtimet e At’ Donat Kurtit nga perspektiva e akteve gjuhësore.

Dr. Karmen Lazri dhe Dr. Zamira Shkreli, Pader Donat Kurti dhe terminologjia gjuhësore (Sipas përkthimit nga gjermanishtja të tekstit mësimor “Gramatika latine” hartuar prej gjuhëtarit dhe

filologut August Scheindler).

Dr. Anisa Kosteri - Doc. Bora Logu, Toponime dhe antroponime me vlerë në veprën e At’ Donat Kurtit. Dr. Erzen Koperaj. Gramatika e At’ Donat Kurtit dhe gramatikat shqipe në dialektin gegë.

Dr. Lisandri Kola - Phd Candidate Aristeja Kola. Mbi përgatitjen e botimit të Testamentit të Rí (Blëni I) përkthye nga At’ Donat Kurti.

Në seancën e dytë të letërsisë, e cila u zhvillua në Auditorin e parë të Kuvendit Françeskan, seancën e drejtuan Prof. dr. Kujtim M. Shala e Prof. as. dr. Arben Prendi.

Në aspektin letrarë kumtuuan studiuesit Prof. dr. Sabri Hamiti me studimin “At’ Donat Kurti simbas At’ Zef Pllumit”.

Prof. dr. Kujtim M. Shala me temën: “At’ Donat Kurti, autori i përrallave”.

Prof. as. dr. Arben Prendi, me studimin

“At’ Donat Kurti folklorist”.

Prof. dr. Ledri Kurti, me studimin: “Provinca françeskane, një udhë drejt formimit të ndërgjegjes kombëtare dhe dijes së një kombi (II) përmes kontributit studimor e dëshmuës të At’ Donat Kurtit”.

Prof. as. dr. Arbnora Dushi, me kumtesën: “Krahasime mbi praktikën e regjistrimit dhe të botimit të këngëve epike: Palaj-Kurti dhe Elias Lönnrot”.

Prof. as. dr. Elinda Dibra, me studimin: “Bota e Prrallave të At’ Donat Kurtit”.

Prof. as. dr. Edmond Malaj paraqiti kumtesën: “Historia e Provincës Françeskane Shqiptare nën dritën e hulumtimeve të At’ Donat Kurtit”.

Dr. Ermira Aliaj me studimin e saj paraqiti temën: “Elemente impaktesh në kërkimet shkencore që mundëson vepra e At’ Donat Kurtit”.

Dr. Ledia Dushi paraqiti studimin: “At’ Donat Kurti mes njerëzve dhe përrallës”.

Dr. Isida Hoxha u ndal në një tjetër këndvështrim studimor me temë: “Publicisti Kurti mes kolonave të shtypit dhe të kulturës”.

Ndërsa Ma. Ndue Ukaj në studimin e tij e vlerësoi veprën e At’ Donat Kurtit në një tjetër dimension. Ai u paraqit me kumtesën: “Kangëtari i dashtënis i At’ Donat Kurtit”. Poezia si etikë dhe estetike.

Të gjitha studimet dhe referatet shkencore të paraqitura në këtë konferencë do të botohen në numrin e ardhshëm të revistës “Hylli i Dritës”, ndërsa ekspozita me dorëshkrimet e At’ Donat Kurtit vijon të qëndrojë e hapur për studiuesit dhe vizitorët.

Për të interesuarit vëllimet e At’ Donat Kurtit gjinden në librarinë “At’ Gjergj Fishta” në Gjuhadol të Shkodrës.

Nga Rita Shkurtaç



Në Pejë u mbajt Manifestimi kulturor “Rreth Flamurit të Bashkuar”

Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” duke vazhduar veprimtaritë e saj kulturore, me datën 25 nëntor 2023, ka mbajtur në Pejë Manifestimin “Rreth flamurit të bashkuar”, duke shprehur kështu respektin dhe krenarinë për ditën e madhe të 28 nëntorit dhe për dëshmorët e kombit. Në këtë Manifestim kanë marrë pjesë edhe kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sanaj dhe poetë e këngëtarë, anëtarë të kësaj Shoqate; pastaj përfaqësues nga Hoti e Gruda dhe trojet tjera shqiptare. Në hapje të kësaj veprimtarie, koordinatori për bashkëpunim me trojet etnike, Rahman Jasharaj ka përshëndetur vëllain Ndue Sanaj dhe gjithë pjesëmarrësit e tjerë në emër të kryetarit Ukshin Jashari dhe veprimtarëve të tjerë të Shoqatës “Martin Dreshaj”. Ai, po ashtu ka falënderuar kryetarin e Pejës, z. Gazmend Muhaxheri për mbështetjen në organizimin e kësaj veprimtarie kulturore.

Drejtuesja Manifestimit, zj. Leonora Lokaj, duke uruar të pranishmit për festën e madhe të Flamurit, ka ftuar kryetarin Ndue Sanaj, i cili ka prezantuar një kumtesë duke rikujtuar data, ngjarje e figura të kombit që nga Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, duke u ndalur pastaj te Ismajl Qemajli, Isa Boleti e komandanti legjendar Adem Jashari.

Përfaqësuesi nga Malësia e Tuzit, Marash Dedëvukaj, ka përshëndetur Manifestimin duke shprehur respekt të lartë për angazhimet e Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”. Pas kësaj pjesëmarrësit kanë lartësuar kujtimin për poetin dëshmor Ymer Elshani, veprimtarinë letrare të të cilit e ka prezantuar Frashër Rraci, sekretar i Shoqatës “Martin Dreshaj”. Pastaj N/ Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, z. Prele Milani, në emër të Kryesisë, familjareve të poetit Dëshmor Ymer Lesheni, ju dorëzuar “Mirënjohja Mehmet Shpendi”, me motivacion: “Për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, deri në sakrificën sublime në luftën për çlirimin e trojeve shqiptare dhe mbeti i pavdekshëm në altarin e Lirisë”

Një moment i veçantë në këtë ngjarje kulturore ishte prezantimi i veprës së Ndue Sanaj “Dukagjini, Shqipëria ime aty 3” nga Aleks Dushi e Rahman Jasharaj. Dushi në vlerësimin e tij ka shprehur respekt për gjithë krijimtarinë letrare të autorit duke u ndalur edhe te vepra “Dukagjini, Shqipëria ime aty 3”.

“Në rrugëtimin tim në shërbim të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë –Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” për t’i pasur në të njëjtën valle, këngë, poezi e në të njëjtën tervezë vëllazërit nga trojet etnike e që i kishin hapur zemrat e dyert e shtëpive në kohët e krahurave e të zhvendosjes biblike të popullit të Kosovës nga terrori e dhuna e pa parë deri at herë e pushtuesit, bashkë me vëllain tim Ukën dhe Mikun Frashër po kërkonim bashkëpunim vëllazëror me Shkodrën, me



këtë pjesë të Shqipërisë, që i dha shumë kombit dhe atdheut nëpër shekuj. Fati ynë i madh bëri që përmes sindikalistit të shkëlqyer Aleks Dushi ta kemi një takim në Shkodër me Ndue Sanaj e për të vënë sot e përgjithmonë bashkëpunimin

vëllazëror në Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”. Filluam këtë rrugëtim të ri me plot ngjarje domethënëse e me suksese të shumta. Ndue krijonte atmosferë entuziazmi edhe në Shoqatën tonë duke na motivuar që të tejkalojmë sfidat dhe të vazh-

dojmë rrugëtimin që kishim nisur. Duke e parë gjithë këtë përkushtim të Ndues, të Gjergjit, të Rozës, të Luigjit, të Preles dhe shumë veprimtarëve të tjerë, në një takim rasti i mahnitur nga gjithë ajo energji pozitive i propozova Ndues që të bëhet





vëlla imi dhe i Ukshinit, duke i treguar se kishim edhe dy vëllezër të tjerë, porse na duhet një vëlla që do të këshillohemi me të për gjithë angazhimet e madje edhe për çështje nga jeta dhe sfidat që sjell ajo. Ndue pranoi dhe ishte dhe mbetet vëlla yni. Ky vëllai ynë sa herë vinte në Dukagjinin e Kosovës ndjehej pak në siklet, sepse njerëzit e kuptuan se për një jetë të tërë ka qenë ushtarak dhe nuk e lenin të qetë ta pinte as edhe një kafe, duke i bërë pyetje e pyetje për ushtrinë shqipe nëpër vite e dekada. Këta pyetësit ishin njerëz që e kishin dashur dhe e donin Shqipërinë dhe bëheshin sy e vesh duke marrë përgjigje për ushtrinë shqiptare dhe rrugëtimin e saj në mbrojtje të atdheut e kombit nëpër vite e dekada. Ndue na përgjigjej në pyetje, por rrjedha e veprimtarive të përbashkëta kulturore, nuk na mundësonte që ta shuajmë kureshtjen tonë. “Kujtimet e një ushtaraku” si dhuratë me vlerë erdhi edhe në Kosovë duke e shuar etjen për pyetjet tona. Unë e lexova dy herë këtë vepër dhe mu shtua krenaria që e njoh autorin dhe e kam vëlla. Forca magjepse e rrëfimit më bëri që të bëhem pjesë e personazheve të librit duke u gjendur në bankat e shkollës, në rrugëtimin e shkollimit, por edhe në ekipet që bënin plane për stërvitje. Duke vijuar leximin ndjehesha se jam njëri nga ushtarët që duhet realizuar detyrat në shërbim të atdheut. Autori, sikur për t’i dhënë pak pushim nga atmosfera ushtarake, me aftësinë e një pende me zë, nxjerr pauza duke ndërlidhur ngjarjet e rrugëtimin plot sfida të ushtrisë e epërëve, me ngjaje nga jeta e njerëzve të rëndomtë.

“Kujtimet e një ushtaraku” meriton të jetë në bibliotekën e ushtrisë shqiptare, të ushtrisë në Kosovë, por edhe e përkthyer në biblioteka të ushtrive kudo në botë sepse ata që kanë zgjedhur të jenë ushtarake e në shërbim të popullit e atdheut kjo vepër u ndihmon shumë që të rrugëtojnë drejt, të veprojnë me kohë e drejtë, por edhe të mbesin ballëhapur kur ë pensionohen. Tani jam duke lexuar me kënaqësi veprën tjetër që rrjedh nga kroi i pastër si loti i Dukagjinit me një titull të qëlluar e simbolik “Dukagjini –Shqipëria

ime aty 3”. Në këtë vepër autori udhëton nëpër dekada e vite dhe na freskon kujtesën për figura emblemë të kombit dhe nuk e fsheh dot se ndjehemi krenar që autori gjeti kohë e hapësirë që edhe emrat e disa prej nesh të jenë brenda faqeve të kësaj dhurate për brezat”, është shprehur Jasharaj. Në këtë veprimtari u prezantua dhe libri i 11-të i studiuesit, poetit, publicistit dhe njërit nga themeluesit e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, z. Luigj Shyti, me titull “Faleminderit miq ...!”, të cilin e prezantoi z. Ndue Sanaj.

Gjithashtu, në këtë veprimtari kulturore, u prezantua edhe libri “Lufta” e autores Leonora Lokaj.

Në pjesën e dytë të Manifestimit para pjesëmarrësve janë prezantuar grupi folklorik “Vëllezërit Panxhaj” dhe këngëtarja Viola Shqau, që kanë shtuar atmosferën festive.

Pas kësaj me vargje të zgjedhura janë prezantuar poetët Prelë Milani, Agim Desku, Sibela Bala dhe Kumrie Shala. Organizatori në këtë Manifestim ka shpallur anëtarë nderi vogëlushin Valon Ndreç Gjollaj në shenjë respekti për angazhimet e tij në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditave shqiptare në Amerikë dhe Aleks Dushin për kontributin në nismat e

bashkëpunimit vëllazëror mes Shoqatës së vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” dhe Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Pjesëmarrësit e këtij Manifestimi pas kësaj janë gjendur në tervezën e përbashkët me bukë, kripë e zemër, mundësuar nga kryetari i komunës së Pejës, Gazmend

Muhaxheri e në respekt të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” dhe miqve nga Shkodra e nga trojet etnike.

RAHMAN JASHARI



Veprimtari e Pasur dhe e Rëndësishme e AT' Camillo Libardit

Në kujtesën e shqiptarëve ruhet e ngjallë kujtesa për shumë misionarë që kontribuan në vendin tonë duke bërë flujime sublime, duka flijuar edhe jetët e tyre në emër të idealeve që mbrojnë. E kam të pamundur që të përmend emrat e të gjithë atyre që ofruan jetët e tyre, duke u vrarë deri edhe të ngulur në hunj për së gjalli, shumica e tyre françeskanë. Midis tyre bie në sy për fuqi shpirti të pathyeshëm figura e një françeskani nga Trento, atë Camillo Libardi, i lindur në Levico me datën 7 dhjetor të vitit 1863, i cili veshi rrobën e fratit në Arco, në vitin 1880. U shugurua meshtar në vitin 1887 dhe erdhi në qershor të vitit 1888 në Pult, në Shqipëri. Këtu qëndroi për 45 vite, duke u dalluar për drejtësi karakteri dhe energji të jashtëzakonshme. Shqipëria në vitet e fundshekullit XIX, ishte e sunduar nga Perandoria Osmane. Katolikët shqiptarë të Veriut ishin të ndarë në gjashtë dioqeza ipeshkvnore, njëra prej të cilave ishte Pulti, me nëntë famulli. Turqit ishin përpjekur që të vendosnin kudo sundimin e tyre, por një qeverisje të vërtetë ata e arritën vetëm në qytete. Në fshatrat malorë, ku vepronte atë Camillo, ishte në fuqi e drejta e tyre zakonore e njohur si "Ligji i maleve", një tërësi zakonesh dhe traditash, që i atribuoheshin kreut të një fisi, Lekë Dukagjinit. Në atë kohë, Shqipëria ishte në një gjendje shumë të prapambetur. Pasuria kryesore ishin pyjet dhe disa ngastrat të vogla toke, ku kultivohej misri, patatja, disa lloje fruta dhe zarzavate sa për mbijetesë. Gjendja e rrugëve ishte shumë e keqe dhe mjetet mekanike të transportit nuk ekzistonin. Për të dhënë një ide të kushteve në të cilat gjendej Shqipëria në fillim të ardhjes së Atë Camilos, mund të informohemi nga artikulli i gjatë kushtuar nga gazeta "Avenire" të Italisë e vitit 1939 për emërimin e tij me titullin Cavalliere (Kalorës). "Gjatë vitit të parë ndodhën 43 vrasje; banda të vërteta vrasësish zbrisnin nga kështjellat e tyre natyrore dhe depërtonin në fushat e Kosovës, rrethonin fshatrat e vegjël ose shtëpitë e izoluara dhe vrisnin, digjinin dhe grabisnin". 2 Artikujt e shumtë që ai botoi në revistat e kohës, janë një përshkrim realist i prapambetjes së thellë dhe i varfërisë së tejskajshme që gjendej popullsia jo vetëm e Pultit ku punonte atë Camile, por edhe i vendeve të tjera rreth e rrotull. Nga dokumentet që kemi në dorë deri më sot, ai ishte i pari që bëri një kodifikim modest për të drejtën zakonore shqiptare me dhjetë kapituj, e cila deri më sot ka mbetur e panjohur për studiuesit shqiptar. Artikujt e tij kushtuar fshatrave të varfra të Dioqezës së Pultit, janë një dëshmi shumë e qartë për vështirësitë që kalonin besimtarët e tij në ato vite. Aty përshkruhen gjendja ekonomike, shëndetësore, kulturore, arsimore, kushtet e jetesës dhe të banimit, doke, zakone, ngjarje të ndryshme si vrasje dhe ngatërresa, vizitat e tij dhe të vizitorëve të tjerë nga vendet evropiane. Një përshkrim shumë realist për jetën e këtij kleriku e gjejmë në librin e Antonio

Baldaçit, të botuar nga "Shoqëria gjeografike italiane" (Societa Geografica Italiana) "Itinerare shqiptare 1892-1902." Në korrik të vitit 1897 ai shkruan: "Malet e Shalës. Jemi drejtuar për në famullinë e fshatit Abat (765 metra), vend kryesor i këtij fisi, i cili është, pa dyshim, ndër më të prapambeturit e të gjithë Shqipërisë, prandaj nga koha e perëndimit të diellit, mbërrimë tek shtëpitë e para të fshatit, ku



dallohen disa fusha të pakta, të vogla, të mbjella me misër e me domate si dhe vihen re disa vija uji për ujtitje. Atë Camillo nga Levico, famullitar, i ri në moshë, në Abat, na pret me kënaqësi të dukshme, si të ishim miq të vjetër. Në këto ana kisha përfaqëson një oazë qytetërimi; disa ditë më pas lexojmë përsëri se atë Camillos, meqë i është dashur të niset këtë mëngjes, na ka lënë këtë letër "[...] natën që shkoi janë vrarë tre burra nga Shala në rrugën që nga Vuthaj zbrer në Theth. Më duhet të shkoj të marr vesh rreth ngjarjes tragjike... Sidomos erdhi një grua të më thërriste për një të sëmurë që është në prag të vdekjes në malet e Thethit. Nuk mundem në asnjë mënyrë të rri me ju". Nga ky aktivitet i jashtëzakonshëm, dhe njohja e gjuhës shqipe, i bënë të mundur atë Camilos që të fitonte nderimin dhe respektin e të gjithëve. Nderimi që ai gëzonte tek besimtarët krenarë të Alpeve shqiptare të Shalës tregohet edhe nga kërkesa që iu bë atij që të kryesonte mbledhjet për të shpallur ligjet e 3 shkruara (1890). Në këto vite ai e meremtoi kishën dhe rezidencën e Shalës, ndërtoi një kishë të vogël në Theth dhe përktheu në gjuhën shqipe disa tekste. Mbas ndryshimeve të thella në qeverinë e Perandorisë Otomane në vitin 1908, si rezultat i revolucionit të Xhonturqve,

ata deshën që të përshtatnin reforma në Perandori. Këto reforma në fillim u pritën me shpresë nga kombet e shtypura të kësaj Perandorie, por shumë shpejt ata u zhgënjyën. Shqiptarët u rebeluan kundër qeverisë. Në vitin 1910 Veriu i Shqipërisë, në pjesën më të madhe katolike, ngriti krye dhe revolta zgjati për gjatë të gjithë viteve 1910, 1911 dhe 1912. Shtëpitë e të krishterëve u dogjën, kishat u shkatërruan

1926, ku u dënuan me dënime të ndryshme 552 burra dhe u dënuan me vdekje 29 prej tyre, shumica të varur në litar. Qeveria e Zogut vari fratin e ri 34 vjeç, dom Gjon Gazullin, me datën 5 mars 1927. Ky veprim, në atë kohë, u dënua nga të gjitha vendet demokratike të Evropës. Të dhjetë mijë mercenarët e Zogut që u angazhuan në 4 shtypjen e kësaj kryengritjeje, ushtruan një dhunë të pa parë mbi popullsinë katolike të Veriut. Libardi, ashtu si në kryengritjen antiturke të viteve 1910, 11, 12, ishte dëshmitar okular dhe shkroi me realizëm për ato ngjarje të tmerrshme që qeveria shqiptare e kryesuar nga Zogu ushtroi mbi popullin e vet. Sipas përshkrimeve që ka paraqitur ai në librin "Si u bë Ahmet Zogu mbret i shqiptarëve" dhuna e ushtruar mbi këtë popullsi nga mercenarët e Ahmet Zogut ishte më e rëndë dhe më poshtëruese se ajo e forcave turke të Shefqet Durgut Pashës të vitit 1910. Ndjenjat, si përkrahës i italianëve, filluan që të ngjallnin dyshime në qeverinë shqiptare, duke e bërë të nevojshëm transferimin e tij në Shenjtëroren e Zojës së Këshillit të Mirë në Shkodër, që gjendej në një zonë më të sigurt, edhe pse ishte e banuar krejtësisht nga muhamedanë. Në fillim, banorët u treguan të ftohtë, por me kalimin e kohës, meqë frati kishte përvojë, përballë Shenjtore, ia doli të ngrinte një ambulator e kjo bëri që qëndrimi i tyre ndaj fratit të "Zojës", sikurse thirrej, të ndryshonte. Madje shumë herë qëndronin tek pragu i derës së Kishës që të dëgjonin predikimet e tij. Në vitin 1932, përkeqësimi i gjendjes së italianëve në Shqipëri e detyroi Kongregatën e Shenjtë të Propagandës Fide, kundër dëshirës së tij, që misionari të kthehej në Itali. U caktua në fillim pranë kuvendit të Pergjinës e pastaj në Cavalese, në Borgo, dhe më vonë do të kthehej në Pergjinë përsëri, ku vazhdoi të zhvillonte aktivisht veprën e tij si meshtar dhe si historian. Në vitet e pranisë së tij në Trento (1933-1942) mbajti disa konferenca rreth Shqipërisë dhe iu kushtua publikimit të disa veprave, mes të cilave një monografi për jetën e Imzot Alberto Cracchi-t, ipeshkëv i Pultit dhe librat historikë si "Si u bë Ahmet Zogu mbret i shqiptarëve" si dhe librin "Lëvizjet e para patriotike shqiptare". Për këto publikime dhe për materiale të tjera të tij, të përzgjedhura me durim në bibliotekat e Napolit, të Lukës dhe të Venecias, të dërguara në Romë dhe të pranuar në "Monumenta Albanie Historica" u emërua Cavalliere (Kalorës) i Italisë dhe anëtar i Komisionit Adriatik për studimet shqiptare. Më 4 janar 1942, ditën e diel, duke u kthyer nga një shëtitje afër Ferinës, u përplas nga një biçikletë dhe u rrëzua për tokë. Në 5 pamje të jashtme kishte marrë vetëm disa plagë të lehta, në sipërfaqe, por që prej asaj dite ai nuk u ndje mirë me shëndet, sepse ankohej për dhimbje të forta dhe dobësi që i shtoheshin. Përkeqësimi vazhdoi të rritej dhe kështu më 22 dhjetor 1942 u shtrua në qendrën shëndetësore të Kuvendit të Rugës Belve-

dere San Francesco në Trento. Këtu ai vdiq më 26 shkurt të vitit 1943 dhe u varros në varrezën e vogël që gjendet brenda kuvendit. Disa njoftime për shkrimet e Libardit para vitit 1900 në shtypin e kohës Libardi filloi punën si famullitar në dioqezën e Pultit në muajin qershor të vitit 1888, pa arritur akoma moshën 25 vjeç. U caktua famullitar në kishën e fshatit Abat në fisin e Shalës që sot emërtohet Komuna Dukagjin. Pa e arritur akoma moshën 26 vjeç, padre Camille Libardi, krahas aktivitetit si klerik famullitar në kishë, e filloi misionin e studimit të dokeve dhe zakoneve të besimtarëve të tij në zonën më të mbyllur të Veriut shqiptar, fshatrave të Nikajt, Mërturit, Shalës, Shoshit dhe zonave për rreth tyre. Në një revistë të asaj kohe, në vitin XVIII të botimit, në numrin 3 të datës 18 janar 1889, në faqen 30, është botuar një shkrim i tij i firmosur nën siglën “Un francescano Trentino(Një françeskan nga Trento)” që nuk lë pikë dyshimi se mbas kësaj firme është dora e meshtarit të ri të famullisë së Shalës, Camille Libardi. Po këtu, në numrin 14 të datës 5 prill 1889, ai botoi një tjetër shkrim me informacione me rëndësi për zonën ku punonte. Me datën 28 qershor 1889, në numrin 26 të kësaj reviste, në faqen 306, botoi një shkrim informues për ngjarjet në dioqezën e tij. Në numrin 34 të datës 23 gusht 1899, në faqen 399, është një kronikë ku përmend Dario Buçarelin, Pal Berishën dhe Alberto Krakin për kontributet e tyre në këtë dioqezë. Nga kjo datë deri me datën 7 korrik të vitit 1891 nuk gjejmë shkrime të tjera në këtë revistë për ngjarjet në Shqipëri. Nga shkrimet e mëvonshme të tij marrim vesh se ai ka shkruar studime dhe kronika, por ato nuk janë botuar. Në numrin 35, të datës 28 gusht 1891, në faqen 414 – 415 në rubrikën njoftime, të revistës kemi një artikull të tij të dërguar 6 nga Dioqeza e Pultit për ta vazhduar punën studimore në numrin 40 të datës 2 tetor, në numrin 41 të datës 9 tetor, në numrin 44 të datës 30 tetor, në numrin 45 të datës 6 nëntor, në numrin 46 të datës 13 nëntor, 47 datë 20 nëntor, në numrin 48 të datës 27 nëntor, në numrin 50 të datës 11 dhjetor, në numrin 51 të datës 18 dhjetor, për të vazhduar në numrin 3 të datës 15 janar 1892, në

numrin 4 të datës 22 janar, në numrin 6 të datës 6 shkurt, në numrin 7 të datës 13 shkurt, në numrin 8 të datës 19 shkurt, në numrin 9 të datës 26 shkurt, në numrin 21 të datës 20 maj 1892 për ta përfunduar ciklin e artikujve në vitin 1893 në numrin 2 të datës 13 janar 1893. Për një kohë të gjatë, bashkëpunimi i Libardit me këtë revistë, nga shkaqe për të cilat ne nuk kemi informata, nuk ka vazhduar. Në artikujt që kemi përmendur më sipër, nëse numërohen karakteret dhe llogarisim një faqe A4 me 2200 karaktere me hapësira, janë shkruar mbi 125 faqe. Ne i kemi përgatitur dhe po i botojmë pa komente dhe pa ndryshime, ashtu si i shkroi ai rreth 130 vjet më parë. Rreth përmbajtjes së këtyre artikujve Në këta artikuj, Libardi edhe pse ishte i ri në moshë dhe pa një përvojë të madhe në shkrime dhe studime, ka bërë një punë mjaft të saktë, pa hollësira të tepërta, me një besnikëri për t'u marrë model në përshkrimin e realitetit të kohës dhe të problemeve që ai i trajtoi. Më së pari po e vlerësojmë shkrimin e të drejtës zakonore shqiptare që ai është i pari që e ndan në “Codice Civile dhe Codice Penale (Kodi Civil dhe Kodi Penal).” Është mjaft e habitshme që asnjë studiues i të drejtës zakonore shqiptare dhe të Kanunit, deri më sot nuk e ka përmendur këtë punim mbi kanunin edhe pse është mjaft i detajuar dhe mjaft i rëndësishëm. Vetëm katër vjet mbas Libardit, studiuesi nga Mali i Zi, Valtazar Bogishiq, ka botuar një version të Kanunit të maleve shqiptare të kodifikuar në 75 nene dhe në asnjë rresht të tij nuk e përmend Libardin. Edhe Shtjefën Gjeçovi në veprën madhore të tij, “Kanuni i Lek Dukagjinit”, nuk e përmend asnjëherë kolegun e tij për kontributin në këtë fushë. Për 7 këtë problem, do të gjeni në dy libra të veçantë të botuar të plotë punimin e tij mbi kanunin. Një problem tjetër me rëndësi madhore që ai ka trajtuar në këto 125 faqe janë problemet e besimeve pagane, zakoneve, dokeve dhe riteve të

malësorëve të Dukagjinit. Ai ka përshkruar me hollësi për t'u admiruar besimin për kuçedrën dhe dragoit, për shtrigat dhe ganecët, për rrufetë dhe për stuhitë, për lugatin, për syrin e keq, për eklipsin e hënës dhe të diellit, për tërmetet dhe për



“hotelin” ku flinte kur dilte në misionet e tij ai shkruan: “Në mbrëmje kur thua: “Hajde të flemë”, shtrati është i këndshëm dhe gati. Kreu i shtëpisë shkon, merr pak sanë, ose kashtë, ose kashtë misri (tallë) sa të mbulojë tokën, i shtrin pranë zjarrit, merr një gur ose një copë dru, e vendos tek koka si jastëk dhe thotë: “Ja, zotëri, është shtrati juaj; Natën e mirë”; dhe kështu le të flejë ai që fle; kush nuk mund të pushojë mund të jetë i mërzi-tur për vdekje duke mos parë kurrë dritën të shfaqet”. Një tjetër kontribut i pamohueshëm i Libardit është kryerja e misioneve në të gjitha fshatrat e famullisë së tij dhe publikimi i shkruar i rezultateve të këtyre misioneve. Në revistat e përmendura përshkruhen plot njëzet e nëntë Misione të realizuara në Pult, Shalë, Okol (Theth), Nik Gjonaj (Theth), Gjellaj (Theth), Gjeçaj (Theth), Ndreaaj (Theth), Grunas (Theth), Ndërlisa, Nikë Lekaj, Dostanishtaj, Nikushaj, Vaçaj, Mar Vataj, Xhaferaj, Camai, Ded Nikaj, Lekaj, Quke, Dakaj, Mëkshaj, Bobi, Vuksanaj, Pjolla, Mar Nikaj, Lotaj, Pap Nikaj, Nicaj, Doçaj. 8 Këto misione të shkruara janë një përshkrim i gjallë i jetës dhe i veprimtarisë njerëzore në këto fshatra në atë kohë. Për kontributin e tij dyzet e

pesëvjeçar në Dioqezën e Pultit, padre Camillo Libardi, meriton një monografi të gjatë ku të përshkruhen me detaje kontributet e tij. Gjithashtu Qeveria shqiptare, Presidenca, Komuna e Shalës dhe Bashkia e Shkodrës i janë borxhli këtij heroi për ta nderuar me tituj nderi dhe për ti ndërtuar buste në shenjë nderimi për kontributin e tij në vendin tonë. Edhe Provinca françeskanë në Shkodër duhet të gjejë mënyrën për nderimin e këtij kleriku të shquar, sipas mënyrave dhe rregullave të tyre.

pesëvjeçar në Dioqezën e Pultit, padre Camillo Libardi, meriton një monografi të gjatë ku të përshkruhen me detaje kontributet e tij. Gjithashtu Qeveria shqiptare, Presidenca, Komuna e Shalës dhe Bashkia e Shkodrës i janë borxhli këtij heroi për ta nderuar me tituj nderi dhe për ti ndërtuar buste në shenjë nderimi për kontributin e tij në vendin tonë. Edhe Provinca françeskanë në Shkodër duhet të gjejë mënyrën për nderimin e këtij kleriku të shquar, sipas mënyrave dhe rregullave të tyre.

MARK PALNIKAJ,
Tiranë, janar 2023

Poezi për Liridona Ademaj

MOS I VRITNI NËNAT!

Zot i madh e i bekuar,
nëse Ti je dashuri,
kjo dhimbje e njerëzimit,
a mund të ketë kufi?

A mund të vritet Nëna,
Ç' pyesin zemrat tona?
Siç bënë me dy të shtëna,
për motrën Liridona.

Të dashur vëllezër e motra,
le të dihet në tokën mbarë,
se kush guxon të vrasë Nënata,
ai s'është burrë shqiptar.

Si mundet, pra, njeriu,
me gjithë këtë begati,
të vrasë pa mëshirë i ziu
edhe gjakun e tij?

Kur Zoti krijoi rruzullin,
bashkë me Diell e Hënë,
aq shumë e lartësoi gruan,
saqë e bëri Nënë.

Mos i prekni Nënata,
se të shenjata ato janë!
Mos i vritni zemrat,
që botën në dorë e kanë!

Liridona, bijë e dashur,
për këtë botë plot ligësi.
Lutu ti, lart nga Parajsa,
që të ketë më shumë mirësi!

Shpirti yt n' paqe pushoftë,
ty të duam shumë Liridona.
Prindërit Zoti t'i ngushëlloftë,
rrofsh gjithmonë në zemrat tona!

NIKOLIN SH. LËMEZHI,
Shkodër, më 03. 12. 2023



Portugalia shtet mik i Kosovës dhe shqiptarëve, Shën Nënë Tereza “një urë që na lidh”

Nga FRANK SHKRELI,
ish-Drejtor i VOA-s për Euro-Azinë

Marrëdhëniet midis Republikës së Kosovës dhe Portugalisë e kanë zanafillën kur Aleanca Euro-Atlantike Perëndimore vendosi të sulmonte Serbinë në mars të vitit 1999, atëherë kur Portugalia si vend anëtar i NATO-s ndihmoi në sulmet ajrore kundër Serbisë dhe më vonë Lisbona dërgoi trupa ushtarake si pjesë e forcave të Nato-s, për ruajtjen e paqës në Kosovë. Marrëdhëniet midis dy vendeve u zyrtarizuan pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt, 2008, kur Portugalia njohu, zyrtarisht, shtetin e pavarur të Republikës së Kosovës në tetor të vitit 2008, njëra prej shteteve të para që bëri një gjë të tillë.

Presidentja Osmani bashkë me kryetarin e qytetit të Lisbonës, Carlo Moedas, përruan shtatoren e shënjtore Shqiptare Shën Nënë Tereza

Në vijim, Lisbona ka vazhduar të tregojë interesimin e saj miqësor për Republikën e Kosovës edhe në nivel ndërkombëtar, sidomos gjatë mandateve të saja si kryesuese e Presidencës së Bashkimit Evropian, në periudha kritike për të ardhmen e Kosovës; sidomos gjatë fazës së bisedimeve përfundimtare në vitin 2007, që çuan më në fund në bashkrendimin e qëndrimeve evropiane për Pavarësinë e Republikës së Kosovës, në Shkurt të vitit 2008.

Sipas Ambasadës së Republikës së Kosovës në Lisbonë, lidhjet miqësore midis dy vendeve janë çimentuar gjatë viteve: rreth 7000-ushtarë portugezë kanë shërbyer në Kosovë, përfshirë një numër të konsideruar zyrtarësh e diplomatësh në misionet europiane dhe ndërkombëtare. Ky numër i madh dinamik po afirmon gjithnjë e më tepër lidhjet dhe marrëdhëniet dypalëshe duke u shndërruar kështu në një urë ndërnyerëzore, kulturore dhe ekonomike bashkëpunimi. Këto janë, njëherësh, edhe themelet e marrëdhënieve tona të së ardhmes- thuhet në portalin e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Portugali. Marrëdhëniet e shkëlqyeshme midis Prishtinës dhe Lisbonës pasqyrohen edhe nga vizitat e nivelit të lartë midis dy vendeve, përfshirë vizitën e 16 Nëntorit, 2023 – e dyta vizitë e Presidentes së Republikës së Kosovës, Zonjës Vjosa Osmani në Portugali. Vizita e parë e Presidentes Osmani në Libonë ishte në Tetor, 2021.

“Kjo shtatore nuk është thjesht një vepër arti, por mbi të gjitha, një urë që na lidhë me idealin e përjetshëm të shërbimit vetëmohues dhe dashurisë për të tjerët.” Vjosa Osmani

Vizita e dytë zyrtare dy javë më parë e Presidentes së Republikës së Kosovës, Zonjës Vjosa Osmani në Portugali, ishte një provë tjetër e lidhjeve dhe një partneriteti të veçantë midis Prishtinës dhe Lisbonës; një pasqyrim i një thellimi të këtyre marrëdhënieve të forta e miqësore diplomatiko-politike, midis dy vendeve. Portugalia, si një vend anëtar i NATO-s

dhe i Bashkimit Evropian, vazhdon të jetë një zë i fuqishëm në favor të çështjeve në interes të Republikës së Kosovës, në nivelin evropian dhe atë ndërkombëtar, përtej Evropës.

Kujtim para statujës së Shën Nënë Terezës Shqiptare në Lisbonë të Portugalisë

Në kuadër të vizitës në Portugali, dy javë më parë, Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani vlerësoi lartë marrëdhëniet e përgjithshme midis Re-

ndentes Osmani përkoi me 15 vjetorin e njohjes së Kosovës nga Portugalia dhe lidhjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy shteteve. “Ky është një moment i rëndësishëm dhe historik për të shprehur mirënjohjen për shtetin dhe popullin e Portugalisë, për kontributin e dhënë përgjatë viteve. Kjo mbështetje ka ndikuar shumë në avancimin e qëllimeve tona parësore në rrugën e integritimit euroatlantike, forcimin e paqës dhe stabilitetit

gjithnjë e më të angazhuar për të garantuar gjithpërfshirjen, diversitetin dhe etikën, në çdo hap të këtij rrugëtimi transformativ”,- është shprehur Zonja Osmani. Ndërkaq, në kuadër të vizitës në Portugali: në një provë të thellimit të mëtejshëm të marrëdhënieve bilaterale presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani dhe Kryetari i Lisbonës, Carlo Moedas përruan shtatoren e Shën Nënë Terezës, e vendosur në qendër të kryeqytetit të Por-



publikës së Kosovës dhe Portugalisë, duke thënë se: “potenciali i këtyre raporteve, në fusha të ndryshme, është i jashtëzakonshëm”. E para e Republikës së Kosovës, gjatë vizitës së fundit në Lisbonë, është takuar me udhëheqësit më të lartë të Portugalisë, përfshirë Kryeministrin António Costa. Presidentja e Kosovës u prit edhe nga Presidenti portugez, Marcelo Rebelo de Sousa. “Kosova dhe Portugalia kanë ndërtuar raporte të shkëlqyeshme, të bazuara në vlera të përbashkëta”,- është shprehur ajo për vizitën e zhvilluar dy javë më parë në Portugali. Vizita e Presi-

rajonat”, -ka theksuar Presidentja Osmani në takimim me Presidentin portugez.

Presidentja Osmani u prit në takim nga presidenti i Portugalisë, Marcelo Rebelo de Sousa

Zonja Osmani vizitoi Lisbonën me ftësë të Web Summit, e shoqëruar nga delegacioni i bizneseve të Kosovës në fushën e ICT-së, ku edhe mbajti një fjalim; një takim ky i nivelit të lartë që në këtë fushë konsiderohet si një ngjarje kryesore e teknologjisë në botë. “Teknologjia duhet të jetë gjithnjë në shërbim të njerëzimit dhe jo ta mbizotërojë atë. Duhet të jemi

tugalisë, Lisbonë. “Bashkë me kryetarin e qytetit të Lisbonës, Carlos Moedas, përruan shtatoren e shënjtore shqiptare Shën Nënë Tereza. Kjo shtatore nuk është thjesht një vepër arti, por mbi të gjitha, një urë që na lidh me idealin e përjetshëm të shërbimit vetëmohues dhe dashurisë për të tjerët. Le të shërbejë kjo statujë si një kujtesë e vazhdueshme e bamirësës më të madhe që njohu njerëzimi!”,- është shprehur Presidentja Vjosa Osmani me rastin e përrimit të Shtatores së Shën Nënë Terezës shqiptare në Lisbonë të Portugalisë.

Në 15 vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, ishte kënaqësi të takoj sërish Presidentin e Portugalisë, Marcelo Rebelo de Sousa. Një shtet jashtëzakonisht miqësor me të cilin na afron angazhimi i përbashkët për paqe, stabilitet dhe progres të vazhdueshëm, ka thënë Presidentja Osmani.

Pa dyshim se edhe vendosja e statujës të Shën Nënë Terezës shqiptare në Lisbonë të Portugalisë, në këtë moment të historisë, në marrëdhëniet e shkëlqyera midis Republikës së Kosovës dhe Portugalisë është një vlerë e shtuar në marrëdhëniet kulturore, dhe tepër miqësore midis këtyre dy vendeve mike dhe një dëshmi e qartë i një marrëdhënieje të mrekullueshme në rritje e sipër midis Prishtinës dhe Lisbonës.



LËVIZJET MIGRUESE TË POPULLIT TONË NDËR SHEKUJ

- BASHKËBISEDIM ME AKADEMIKUN MARK TIRTA "NDER I KOMBIT" RRETH LIBRIT TË TIJ



Bashkëbisedoi
FRAN GJOKA

- Prof Marku, cilat kanë qenë disa nga shkaqet më kryesore që Shqiptarët janë shpërngulur nga trojet e tyre gjatë gjithë periudhave të historisë?

Shkaqet e lëvizjeve migruese të Shqiptarëve janë nga më të ndryshmet. Në disa raste janë shumë e shumë faktorë shtysë për migrim të popullsisë, po për dyndje të caktuara mund të jetë vetëm një shkak i rastit, po doemos një ndodhi tepër e rëndë. Kështu, fshatrat Shestani, Brisku e Livari u detyruan të ikin natën, sa andejkëndej më 1726 e deri më 1733 e së fundi, me ndihmë të arqipeshkëvit Vinçens Zmajević u vendosën për jetesë në Borgo Erico pranë Zarës në Dalmaci, ku ishin nën mbrojtjen e Venedikut. Po si ndodhi kjo? Disa ushtarë të ushtrisë së shtetit turk, ashtu si thuhet në disa shkrime, kishin përdhunuar femra të këtyre fshatrave. Si rrjedhojë, fshatarët vranë disa ushtarë. Nga kjo, këta të fundit do ta pësonin tepër rëndë. Kështu, për këta banorë nuk kishte rrugë tjetër veçse të ikin me tërë familjet e tyre, gjë që e bënë menjëherë.

Arsyet e migrimit të popullsisë, si më thelbësore, se ato në kuptime të ndryshme, që janë tepër të shumta, mund t'i përmbledhim në 4 shtysa kryesore: 1. pasiguria, ku rrezikohet jeta e njerëzve; 2. përzënie e popullsisë me forcë, gjë që ndër të tjerë e kanë bërë Serbët që i kanë shpërngulur Shqiptarët nga trojet e tyre në Jugosllavi e më tej për t'i populluar ato vende me popullsi sllave; 3. varfëria e tepërt i detyrojnë njerëzit, familjet, që të emigrojnë; 4. njerëzit, familjet, emigrojnë për të gjetur një vend më të mirë për jetesë, edhe pse nuk janë dhe shumë të varfër. Nga malet jo pak popullsi ka zbritur nga malet e vendosur në ultësira fushore, në bregdet, ku jetesa mund të organizohet dhe më mirë. Në jo pak raste, nga luftërat, nga pasiguritë e jetës, popullsia ka ikur nga fushat e është vendosur me banim në male.

- Migrimi i jashtëm ka qenë një plagë e rëndë për popullin tonë ndër shekuj. Cilat kanë qenë momentet më tronditëse që e kanë detyruar popullin tonë të migrojë në mënyrë masive nga vendi i tij?

Është e vërtetë se mërgimi në kohë të

ndryshme ka qenë një plagë e rëndë: na ka penguar shumë në zhvillimin ekonomik e shoqëror. Po duhet ditur se migrimet e ndryshme, ndonëse të dhunshme e në fatkeqësi, na kanë lidhur me popujt më të qytetëruar. Jo pak emigrantë, djem e nipa të tyre, në vendet e huaja ku jetuan e u shkolluan, u bënë njerëz të mëdhenj për ato vende ku jetuan, shumë prej tyre i shërbyen së tepërmi dhe atdheut prej nga e kishin prejardhjen.

Ndodhi tronditëse, që kanë detyruar bashkësi të mëdha të popullit tonë të ikin nga atdheu i tyre e të vendosen në vise të popujve të tjerë, kanë qenë të shumta. Janë larguar prej këtej për të shpëtuar jetën e tyre, për të shpëtuar fëmijët. Disa ikin në male a në vende më të mbrojtura, ku përgatiteshin dhe për qëndresë

ndaj pushtuesve grabitës e përdhunues; të tjerë ikin ose drejt Greqisë, me varka drejt Italisë të larguar nga Veriu, nga Mesi a nga Jugu i këtij vendi. Këto batërdi me plaçkitje e me masakra i kanë bërë ndër Ilirë: pushtuesit romakë e ata helenë, i kanë bërë turma fisnore, popujsh të ardhur nga Veriu i Evropës, nga Perëndimi (deri nga Anglia), po dhe nga lindja e Evropës e nga Azia. Nga koha në kohë, në Antikitë e në Mesjetën e Hershme, po dhe më vonë, vërshuan mbi viset e Ilirisë grupe fisnore e bashkësi luftarake për të grabitur e ku bënë masakra tepër të egra. Ndër këta ishin: Keltët, Vizigotët, Normanët, Hunët nga Azia, Vandalët, Vikingët, Tartarët. Është e çuditshme se si në këto përjetime tragjike, ka bërë dhe të organizohen e të njëjtësohen më fuqishëm në një etni të

gjerë e kompakte. Një pjesë e popullsisë dhe ka emigruar në vende të huaja për t'u shpëtuar masakrave e atje janë shpërbërë si njësi etnike stërgjyshore. Duhet theksuar se në disa vende u kompaktësuan emigrantët e ruajtën gjuhën e veçoritë etnike të prejardhjes.

Masakra të përbindshme dëshmohen dhe në kohën e sundimit Bizantin, po dhe kur u lëshuan mbi trojet arbërore pushtuesit bullgarë, aq më shumë kur në këto bashkësi arbërore u vërsulën Serbët rrëmbyes e shfarosës të popullsisë arbërore. Doemos, edhe në këto kushte ka pasur lëvizje migruese të popullsisë. Rreziku i zhdukjes e bënte këtë: që të ikin e të fshiheshin ndër popuj të tjerë. Në një pjesë të trojeve arbërore popullsia, për t'i shpëtuar tmerrit u bullgarizua e më



në veri u serbizua. Po më në jug të trojeve arbërore banorët u greqizuan. Pra në ato kohë nga pushtimet Arbërorët kanë përjetuar tmerre. Kjo është krejtësisht e vërtetë, edhe pse dëshmitë janë më të pakta e anësore.

Koha e pushtimit osman e masakrat e pushtuesit janë edhe më të dëshmuara në shkrime të kohës. Një pjesë jo e vogël nga popullsia iku në Greqinë Perëndimore. Prej andej një pjesë e saj kaloi në Italinë Jugore. Emigroi popullsi për në Dalmaci që akoma nuk ishte pushtuar e në tërë bregdetin shqiptar, iku jo shumë popullsi për në Itali të Mesme e në atë të Veriut. Jo pak nga këta emigrantë, nga Veriu apo Mesi i Italisë, kaluan te bashkëkombësit e tyre në Jug. Dëshmitë na e thonë se në këtë kohë, pra të pushtimit Osman, andejkëtej, te popuj të ndryshëm, ka pasur dhe shumë grupe të tjera mërgimtarësh. Kjo batërri e madhe e pushtimit Osman detyroi grupe të tëra njerëzish të iknin jashtë atdheut për të shpëtuar jetën.

Shpërnguljet e Shqiptarëve me dhunë nga trojet e tyre, shoqëruar me masakra të bëra nga Serbët e nga Grekët, janë të shumta e të rasteve të veçanta, sidomos më së tepërmi më 1877-1878, më 1911-1914, më 1918-1924, më 1939-1943. Po sjellim vetëm pak të dhëna: janë zhdukur fizikisht ose janë përzënë nga trojet e tyre më 1877-1878 më shumë se 200.000 Shqiptarë që nga Korshumbia e deri në Nish e Vranjë. Nga Fusha e Nikshiqit në Mal të Zi u masakruan e u shpërngulën më 1895: 400 familje shqiptare me më shumë se 2000 frymë. Më 1914 u masakruan e u shpërngulën me forcë 16.530 Shqiptarë e shumica e tyre u drejtuan për në Turqi... Ushtria serbe e ajo malazeze më 1912 kanë vrarë në Kosovë 12.777 Shqiptarë. Akademiku bullgar, profesor i Universitetit të Sofjes, na vërteton se më 1913 janë masakruar nga ushtria serbe 120.000 Shqiptarë në vatrën e tyre në Maqedoni.

Shifrat e masakrave e të dyndjeve me forcë nga vendbanimet e tyre nuk kanë të sosur

- Një nga destinacionet e lëvizjes migratore të Shqiptarëve ishte edhe Jugu i Italisë, ku u ndërtuan fshatra të tëra me Arbëreshë, të cilët kristalizuan gjuhën, zakonet, traditat që i ruajnë edhe sot. Kur ka ndodhur saktësisht kjo lëvizje migratore dhe cilat kanë qenë arsyet?

Vërehet se së paku që nga epoka e bronzit e ajo e hekurit, në bashkësi të ndryshme të Evropës, ndër fise të ndryshme, mbizotëronte mendimi i lëvizjes drejt ultësirave mesdhetare, po dhe praktikohet në shumë bashkësi, të emigruarit drejt vendeve më në Jug të Evropës, pra dhe afër brigjeve të Mesdheut, në ultësira, ku klima ishte më e ngrohtë, ku kishte vende të përshtatshme për bujqësi. Prej andej mund të shkohej më lehtë në vende të tjera me varka. Në Bregdetin Jugor dhe komunikimi ekonomik, shit-blerja, ishin më të lehta, më të praktikueshme.

Ashtu si ka ndodhur dhe me popujt e tjerë, dhe Ilirët e Parailirët, si bashkësi të veçanta të tyre, kanë emigruar e janë vendosur në Greqi, në ishujt më jugorë të Greqisë, në brigjet e Marmaras, në jug të Italisë, në ishujt të saj. Këto migrime e ngulime janë vërtetuar nga dijetarë se-

riozë, edhe pse dëshmitë themelore janë të pakta e disa herë të sipërfaqshme.

Për shekulli XV me pushtimin Osman, migrimet e Shqiptarëve në Greqi e në Itali janë shumë të mbështetura në dëshmi të ndryshme të pakundërshtueshme. Së paku Greqia Jugperëndimore e ajo Perëndimore, kur Osmanët pushtuan pjesë të trojeve shqiptare e më vonë të tërë Arbërinë, nuk dukej se do të pushtohej prej këtyre Aziatikëve, dhe kështu shumë turma Shqiptarësh ikën e u vendosën në Greqi, në More e në shumë ishujt të saj. Kur u duk dhe atje pushtimi Osman, shumë emigrantë shqiptarë kaluan në Italinë Jugore ku jetuan për disa shekuj. Në këtë kohë (shek. XV) jo pak Shqiptarë kaluan nga brigjet e Adriatikut e të Jonit e u vendosën në Itali. Kaluan disa dhe nga Shkodra, bregdeti Ulqin-Tivar, nga Dalmacia e u vendosën në Trieste, në Venedik, po dhe në vise të tjera të Veriut të Italisë. Një pjesë e madhe e këtyre që u vendosën në Italinë Veriore e atë të Mesme, pas disa kohësh shkuan e u vendosën në Jug, duke mbushur fshatrat arbëreshë të atij vendi, pranë bashkatdhetarëve të tyre.

Në këto kushte është formuar e zmadhuar bashkësia Arbëreshë në Jug të Italisë, në Siçili. Arsyet e shkruarjes janë: "bashkëvëllezërit" e tyre, klima, vend më i mirë

punës shkencore.

Emrat që përmenden këtu janë gjuhëtarë e janë marrë dhe me probleme të folklorit. Brenda këtij kuadri (gjuhë e folklor), kanë shkruar dhe për jetën e historinë e Arbëreshëve të Italisë. Migrimi nuk ka qenë temë qendrore e studimeve të tyre. Për ato që janë marrë nga ato shkrime janë vënë referenca, ashtu si dhe për shumë e shumë autorë të tjerë. Të marrësh mendime e dëshmi vërtetuese nga autorë të ndryshëm, kjo është brenda kodit të kërkimit, duke përmendur burimin; unë kështu kam bërë e mendoj se jam krejtësisht brenda rregullave të lojës. Unë i kam parë migrimet shqiptare në syrin e etnologut e në vështrim gjithëpërfshirës. Pra kjo nuk ka të bëjë më plagjiaturë, me vjedhje të punës së tjetrit. Në vendin tonë ka shumë të ashtuquajtur "studiues" që janë plagjiaturistë, pra vjedhës së punës së të tjerëve. Janë bërë dhe "Prof. Dr.", po ata mendoj që me ligje shtetërore të quhen "Hajdutë Prof. Dr.". Këtë ta bëjë Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Historiani, profesor i mirënjohur Zija Shkodra, ka bërë disa shkrime shkencore për diasporën shqiptare e për migrimet shqiptare, për këto ka folur dhe në librat e tij shkencorë. Unë jam mbështetur në dëshmitë vërtetuese e në mendimet e tij,



për burime të jetesës, për tregti dhe në raste të ndonjë rreziku dhe më lehtë për të ikur në vende të tjera të Mesdheut.

Për lëvizjet migratore është shkruar shumë. Kam parasysh studiuesin e njohur Kolë Kamsi, Eqerem Çabejn, Gjovalin Shkurtajn, e ndonjë tjetër. Ç'të reja sjell vepra juaj në krahasim me këta autorë të njohur?

Kur shkruhet një punim shkencor, qoftë ky prej disa faqeve ose dhe një libër me shumë faqe, merren të dhëna si fakte vërtetuese ose dhe si mendime, nga autorë të ndryshëm seriozë, qoftë dhe kur ka shkruar për këtë dhe vetëm një a dy faqe. Ato që merren, referohen në një mënyrë a në një tjetër, sipas rregullave të kodit të

po gjithnjë me referenca. Zija Shkodrën e kam pasur udhëheqës shkencor në procesin e mbrojtjes së doktoraturës në vitet '80 të shek. XX, me temë "Migrimet e Shqiptarëve". Para mbrojtjes e deri në mbrojtje është diskutuar disa herë në nivele të ndryshme e kurrë njëri ndër diskutuesit nuk u tha edhe një fjalë për plagjiaturë.

Shpesh studiuesit që janë marrë me lëvizjet migratore flasin me kompetencë për vendndodhjen e shqiptarëve të emigruar nëpër vende të ndryshme të botës, por shpesh mungon prejardhja e tyre, madje në shumë raste jepet vetëm krahi, mungojnë fshatrat, fiset etj. Nuk gjenden dokumente dhe dëshmi për të saktësuar prejardhjen e tyre?

Emigrantët kur largohen nga atdheu i tyre nuk bëjnë regjistrime në vendlindje, po vetëm në vendin e ri ku ngulen. Largimet nga vendlindja në përgjithësi janë bërë në heshtje, pa u ndjerë e pa bërë regjistrim në ndonjë vend të vendbanimit. Kanë ikur prej andej duke u përqaftuar vetëm me të afërm e miq që i përcjellin. Në këto rrethana studiuesi e ka të vështirë të gjejë dëshmi të plota, statistika për tërë ata që ikin nga fshati a lagja ose qyteti i tyre. Ata ikin në mënyrë të çrregullt, të thuash se në heshtje, disa herë në "fshehtësi". Kur kalojnë kufirin e në vendin ku ngulen me banim bëhen regjistrime të rregullta, madje dhe disa herë. Emigrantët në vendin ku ngulen studiuesi i studion me shumë dëshmi e regjistra popullsie. Pra ky është shkaku që në vendin ku ngulen ata të studiohen më në hollësi e me shumë dëshmi e statistika të shkruara. Edhe vendi prej nga largohen është mirë të studiohet e të saktësohen në hollësi gjërat, po kësaj së parës nuk i japin dhe shumë rëndësi. Ka raste që atë ta japin në përgjithësi, po ka dhe pasaktësi. Kjo gjë e dëmton studimin.

Ju në libër thoni se në Greqi kanë emigruar ilirë, arbër, shqiptarë. Cilat kanë qenë arsyet e këtij migrimi periodik nga Shqipëria në Greqi dhe ku janë

vendosur ata, veç Çamërisë?

Jo pak popuj indoevropiane që banonin në mesin e Evropës në Neolit, zbritën në Jug të Evropës, pranë Mesdheut ku klima ishte e butë, kushtet natyrore për jetesë për t'u ushqyer ishin më të mira; lidhjet ekonomike, tregtare me popujt e tjerë e bënin jetën më të mirë. Në periudhën e Bronzit erdhën në Ballkan Ilirët që më shumë u vendosën në Perëndim, po jo pak prej tyre u vendosën në Jug të Gadishullit, pra në Heladhën e lashtë; Grekët erdhën e u vendosën aty ku janë edhe sot duke shpërbërë e helenizuar bashkësitë Ilire të atyre vendeve. Në tokën helene erdhën në ato kohë dhe Trakë, Dako-Getë, Dorë e bashkësi të tjera që më vonë u shpër-

bënë, u helenizuan. Shtresën më të vjetër të popullsisë ilire në Greqi, në ishujt e saj e vërtetojnë, e përcaktojnë disa dijetarë të mëdhenj me gjetje mbijetoja toponimesh, antroponimesh, mbetëza fjalësh e shprehjesh që i takojnë gjuhës Ilire. Ilirët më të lashtë në Greqi janë shpërbërë që në Antikitët.

Migrime ka pasur edhe në shumë vende të tjera të Ballkanit. Kam parasysh këtu pakicat kombëtare në Ukrainë, Bullgari, Rumani e sidomos në Kroaci. Pse përmenden rrallë nga studiuesit këto lëvizje migratore?

Në Rumani ka pasur shumë emigrantë shqiptarë; jo pak ka pasur dhe në Bullgari, madje në Rumani e në Bullgari kanë pasur dhe organizim shoqëror; në Rumani dhe shkolla shqipe. Në shumicën e rasteve emigrantët shqiptarë në Ballkan, pra dhe në Dalmaci e deri në Ukrainë e në Poloni kanë shkuar më shumë nga vende të tjera e jo nga Shqipëria, prandaj janë njohur pak e aspak e nuk është shkruar për ta fare ose tepër pak.

Ç' dihet sot për lëvizjet migratore, të ndodhura pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, dyndje e cila vazhdoi deri në vitin 1945. Ku u vendosën Shqiptarët në këtë periudhë?

Nga koha e Shpalljes së Pavarësisë e deri më 1945 ka pasur shumë migrime Shqiptarësh: disa si shpërngulje me forcë e disa nga varfëria: migrim për një jetë më të mirë e më të qetë. Brenda vendit: nga malet kanë rënë e janë ngulur në kodrina e fusha bregdetare. Shumë Shqiptarë emigruan në vende të ndryshme të Evropës e në Amerikë (kryesisht në SHBA). Sipas librit "Amerika", ku në tërësi flitet për emigrantët në SHBA, në atë vend kishte 50.000 Shqiptarë, kryesisht nga Jugu i këtij vendi e shumë pak nga Veriu.

Shpërngulje me forcë, me përdhunë e popullsisë shqiptare nga trojet e saj amtare kanë ndodhur disa herë që nga projekti "Naçertanie" i Garashaninit më 1844 dhe "Megallo Idheja" greke e po kësaj kohe. Që nga ajo kohë kanë nisur migrimet me forcë: Kostur, Follorinë e vise të ndryshme të Çamërisë. Nga vitet 1877-1878 pati dyndje të shumta nga viset shqiptare të Maqedonisë, nga vise të shtetit serb, nga Mali i Zi. Po nga këto vise dyndje të mëdha me përdhunë ka pasur më 1911-1914, më 1920-1924, po dhe në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Me dhjetëra mijëra Shqiptarë myslimanë i nisën me forcë për në Turqi. Shumë prej tyre, për t'u shpëtuar barbarizmave serbe e në Çamëri të Grekëve ikën në mërgim në shtete të Perëndimit e me mijëra erdhën e u vendosën në Shqipëri.

Masakrat ndaj Shqiptarëve në trojet e tyre në Maqedoni, në Çamëri, në Nish-Shkup-Kurshumli, në Mal të Zi, kanë qenë marramendëse, po këtu po paraqesim vetëm ndonjë shembull: Sipas të dhënave të një komisioni ndërkombëtar, më 1920-1922 në Dibër - Maqedoni kemi nga masakrat 8609 të vdekur; 1394 të masakruar në vatrën e tyre, 3744 vdiqën nga plagët e sëmundjet mbinjerëzore, 4855 u vranë në ndeshje me Serbët. Në këtë kohë u larguan nga Dibra këndej e andej kufirit 55068 frymë (sipas të njëjtit komision).

Cilat qenë arsyt e mungesës së migrimit gjatë viteve 1945 - 1990. A pati lëvizje migratore gjatë kësaj periudhe dhe

si realizohej kjo lëvizje?

Nga 1945 deri 1990, në kohën e regjimit komunist, kufijtë u mbyllën, pra nuk i lejoi njerëzit të iknin jashtë Shqipërisë. Kanë ikur vetëm duke u arratisur e shuma e tyre, sipas dëshmimeve arkivale, shkon në 3000 vetë. Në përgjithësi këta kanë ikur në SHBA, po pak prej tyre janë vendosur me banim në shtete të ndryshme të Evropës si në Itali, Holandë, Angli, Zvicër e në ndonjë vend tjetër. Ndalohej nga shteti çdo komunikim me këta "të arratisur", veprime të tilla dënoheshin shumë rëndë.

Migrime të shumta pati edhe nga Kosova, sidomos në kushtet e terrorit serb. Cili ishte destinacioni i të përngulurve kosovarë në Evropë?

Shpërngulje me forcë, me përdhunë, bërë nga Serbët, e Shqiptarëve nga trojet e tyre në Kosovë, në Shkup, në Prokuplje, në Leskovsk, në Mal të Zi, ka pasur me shumicë e me masakra rrëqethëse më së shumti më 1877-1880, më 1912-1914, 1920-1924 e së fundi më 1998-1999. Në këto shpërngulje tmerruese janë masakruar e vrarë jo vetëm burra që ishin në shesh të luftës për mbrojtje, por dhe gra, fëmijë, pleq e plaka. Disa emigruan në Turqi se andej i shtynte Serbi, disa në perëndim dhe jo pak mundën të vijnë në Shqipëri e të ngulen në viset fushore.

Cilat qenë zonat më të prekura nga lëvizjet migratore gjatë shekujve, pasi nga studiuesit flitet për vale lëvizjesh, por nuk jepen saktë vendet nga kanë lëvizur masat migratore?

Migrime në periudha të ndryshme historike ka pasur nga tërë trojet shqiptare, por gjatë Rilindjes e Pavarësisë shumë më tepër migrime ka pasur nga Gjirokastra, nga Korça, Kolonja e Përmeti, nga Bregdeti Himarë-Sarandë. Këto vise, ndër shekuj kanë qenë të lidhura me tregti me Greqinë, me Turqinë, me vendet e lindjes, me Mesdheun. Pra për këta kanë qenë vende të njohura. Prej andej u njohën dhe me vendet e Perëndimit e së fundi dhe me Amerikën, me SHBA. Migrime të rregullta për në SHBA, në vazhdimësi kishte që nga viti 1897 e këtej. Më 1910-1911 në SHBA kishte, sipas statistikave, 10.000 Shqiptarë, më 1918 kishte rreth 30.000 Shqiptarë, po 15.000 u kthyen për të organizuar e mëkëmbur shtetin shqiptar. Disa nga këta e të tjerë me shumicë, nga varfëria ikën përsëri në SHBA. Dëshmitë e shkruara thonë se më 1945 në SHBA kishte rreth 50.000 Shqiptarë, nga të cilët vetëm 3000 nga Malësitë e Veriut. Këtu ka jo pak nga ata të përzënë me përdhunë nga Serbët e nga Grekët, në trojet e tyre, por që nga Fuqitë e Mëdha iu aneksuan këtyre shteteve.

Mund të na thoni disa figura shqiptarësh që kanë emigruar në vende të ndryshme, por që kanë luajtur rol të rëndësishëm në botë si p.sh Papa Klementi XI, emigruar nga Shqipëria pas vdekjes së Skënderbeut, a ndonjë tjetër?

Janë të shumtë emigrantët, fëmijë e pasardhës emigrantësh që u shkolluan në shtetet ku u ngulën. Disa prej tyre u bënë njerëz të mëdhenj në kulturë e dije, në veprimtari shkencore e shoqërore në shërbim të vendit ku jetonin e sidomos të atdheut nga e kishin prejardhjen. Nuk është e mundur të qartësohen si duhet e të tëra ato figura të shquara të dijës, të veprimtarive shoqërore, të atdhetarizmit, siç

ishin ta zëmë Rilindësit tanë Abdyl, Naim e sidomos Sami Frashëri që u bë dijetar i madh, autor librash, hartues i enciklopedisë së parë të Turqisë, ku përshkruhen dhe mendje të ndritura të shqiptarizmit. Po japim disa fytyra të shquara në emigracionin shqiptar e që bënë emër në histori, në kulturë:

Si na e qartësojnë disa të dhëna të shkruara të Mesjetës e si e vërteton me burime të ndryshme e zbërthime të thelluara studiuesi i shquar Kristo Frashëri: ka qenë Papë i Romës Inoçenti I, me prejardhje Ilire, nga fisi Albanoi, në vitet 401-417. Kjo është shumë domethënëse për Ilirët e Albanët e Mesjetës.

Gjon Gazulli (1400-1465), lindur në Raguzë e me prejardhje nga një vëllazëri fisnike e Vigut të Mirditës. U shkollua në Raguzë e universitetin e bëri në Padova të Italisë ku dhe u doktorua më 1430. Profesor në matematikë e astronomi, përgjegjës katedre e pedagog për disa vjet. Bëri shpikje në kërkimet shkencore në astronomi e për këtë njihet në botë. Është marrë me diplomaci në Raguzë. Lidhje kishte me Skënderbeun e kontribuues në çështjet shqiptare të kohës.

Papa Klementi XI (1649-1721), lindur në Udino (Itali), prejardhje stërgjyshore nga Laçi i Kurbinit. Arbëresh. Pati një sqetësi të jashtëzakonshme. E ngarkuan me detyra në hierarkinë kishitare. Nga dijet e shkathësia e zgjodhën Papë. Ndihoi shumë në probleme të atdhetarizmit shqiptar. Qe shtysë e programues i Kuvendit të Arbërit që u bë në Mërgjijë të Lezhës më 1703 e që e organizoi Vinçens Zmajeviq me disa Shqiptarë atdhetarë të tjerë.

Karl Gega (1802-1960). Origjinë shqiptare, nga malësitë e Veriut. Lindur në Venedik. Mbaron kolegjin ushtarak për filozofi e matematikë; u diplomua në Universitetin e Padovës për inxhinieri. Më 1919 mori titullin "Doktor" në matematikë. U muar me ndërtim të kanaleve të ujërave e të rrugëve, kryesisht hekurudha në Itali e Austri. Si kryeinxhinier, u ngarkua me studimin, projektimin e ndërtimin e hekurudhave. Bëri gjetje shkencore të panjohura në ndërtime hekurudhash dhe me shumë tunele e kështu u bë i njohur në botë si zbulues kodesh të reja në këto ndërtime.

Hasan Tahsini (1811-1881). Lindi në Ninat të Çamërisë (Sarandë). U vendos me banim në Stamboll ku vazhdoi studimet, i specializuar në matematikë, astronomi, psikologji; shkroi punime shkencore e libra me shumë vlerë. Për gjerësinë e thellësinë e dijeve që zotëronte tërhoqi vëmendjen e të diturve dhe u bë rektori i pari i Universitetit të parë në Stamboll (1870). Si dijetar i shquar u bë i njohur në tërë Perandorinë Osmane. Ishte aktiv në veprimtari kombëtare të Rilindasve Shqiptarë në Stamboll. Bëri një alfabet të shqipes. Ishte në komisionin e krijimit të alfabetit të shqipes më 1878. U dha me mish e me shpirt në shërbim të Pavarësisë dhe të shkollës e të librave shqip.

Elena Gjina (Dora D'Istria) (1829-1888). Shkrimtare e publiciste e lindur në Shqeri të Përmetit; migroi me prindërit e saj në Rumani ku dhe u shkollua e u bë një emër shumë i njohur në Rumani e ndër Shqiptarë, në atdhe e në mërgim. Ajo shkroi shumë për Shqiptarët, për figurat e shquara të këtij vendi në mërgim. U

lidh me Rilindasit, me mërgimtarët e dha ndihmesë të madhe në shërbim të lëvizjes kombëtare të Rilindjes. Në studimet e saj pasqyroi historinë dhe atdhetarizmin shqiptar përmes këngëve popullore.

Françesko Krispi (1818-1901). Lindi në Ribera të Siçelisë nga prindër Arbëreshë. Qe personalitet i madh në organizimin e shtetit të ri italian. U zgjodh deputet i Parlamentit të parë italian (1861) për Firencën. Qe kryeministër i Italisë (1887-1891, 1893-1896). Ndihoi në hapjen e shkollave italiane e shkolla shqip në Shqipëri e në Arbëreshë.

Sami Frashëri (1850-1904). Nuk mund të lëmë pa përmendur tre vëllezërit Frashëri, të lindur në Frashër të Përmetit, të shpërngulur nga vendlindja e të ngulur në Janinë ku dhe u arsimuan. Prej këtej shkuan në Stamboll ku e kaluan jetën. Këta qenë tre kolosë të mëdhenj të lëvizjes kombëtare gjatë Rilindjes. Qenë organizues të veprimtarive atdhetare. Abdyli shkëlqen në lëvizjen politike, atdhetare, për pavarësinë e Shqipërisë; Naimi shkëlqen në shkrime letrare e me frymë atdhetare; Samiu qe një dijetar i veçantë në shkencat shoqërore. Shkroi shumë libra shkencorë e kulturorë për atdheun e tij të lindjes e për Turqinë: fjalorë e vepra historike. Është autor i fjalorit enciklopedik Osman (Kamus-ul alam), 1900, në 6 vëllime ku flitet shumë për historinë e për figura historike shqiptare. Problemeve të Rilindjes shqiptare u kushtoi jetën. Libri "Shqipëria çka qenë, ç' është e çdo të bëhet" është një manifest i Rilindjes Kombëtare shkruar prej tij.

Viktor Eftimiu (1889-1972). Lindi në Boboshticë të Korçës e jetën e kaloi në Rumani. Radhitet ndër përfaqësuesit më në zë të letërsisë rumune të shek. XX. Si dijetar e shkrimtar mori titullin akademik. Ruajti lidhjet shpirtërore me Shqipërinë e shkroi shumë për Shqiptarët e Shqipërinë, përkrahu me forcë interesat e atdheut ku lindi.

Personalitetet e shquara të migrantëve shqiptarë janë të shumtë e me shumë veprimtari ndaj atdheut, po këtu nuk është e mundur të jepen.

Ç' mendim keni për studimin e thelluar të lëvizjeve të jashtme migratore. A ka ardhur koha që studiuesit të punojnë më me interes në këtë fushë pasi ka shumë pika të errëta dhe paqartësi në këtë aspekt! Si mund të organizohet një studim i tillë?

Migrimet e jashtme, po dhe ato të brendshme duhet të studiohen në thellësi e në gjithanshmëri, me projekte të bëra me përkushtim e me dije të thella për popullsinë. Deri sot ka shumë gjëra të pasquruara. Studimet bëhen me statistika, po duhen bërë me eksplorime gjithëpërfshirëse me burime nga më të ndryshmet. Sot, sipas të dhënave të ndryshme të shkruara, ka në botë rreth 16.500.000 Shqiptarë; 6.500.000 në trojet e tyre stërgjyshore e 10.000.000 në diasporë. Këto shifra nuk janë të vërtetuara sa duhet. Duhet specialistë të përkushtuar që ta bëjnë këtë kërkim shkencor për migrimet.

**Profesor Marku,
ju faleminderit
për bashkëbisedimin!**

RENATO JETON - TË RINJTË E BASHKISË SË VAU DEJËS PËRKUJTOJNË SHOKUN E TYRE

E ndërsa qyteti i Laç Vau Dejës, nuk është zgjuar ende mirë, më datën 8 tetor 2023, një grup të rinjsh kryesuar nga Antonio Pjetraj kanë nisur përgatitjet e fundit të nismës së tyre "Renato Jeton". Askush nuk e kishte menduar se miqtë e kanë dashur kaq shumë, sa vijnë prej 3 vitesh ta përkujtojnë shokun e tyre me një sërë veprimtarish dobiprurëse për bashkësinë ku u lind dhe u rrit i riu 21 vjeçar, i cili humbi jetën tragjikisht 2 vite më parë në Angli, aty ku e kishin drejtuar ëndrrat për një jetë më të mirë, ëndrra që atdheu i tij nuk ia përmbushi.

Nisma "Renato Jeton" është forma më origjinale dhe më e mirë jo vetëm për të kujtuar një të ri të talentuar që shkëlqeu në vendlindje për aq kohë sa jetoi, por dhe përcjellë një mori mesazhesh, të cilat do t'i zbulojmë gjatë këtij reportazhi. Të gjitha këto cilësi ndihmuan në lindjen e idesë, se një mik të mirë mund ta përkujtojmë me veprimtari, që ai i deshi aq shumë. Për këtë arsye, u mendua që ato të zgjasnin 3 javë duke ndikuar ndjeshëm në jetën e bashkisë së Vau Dejës.

Ende më drithëruese është biseda që zhvillojmë me motrat e Renatos, të cilat kanë ardhur të mbështesin veprimtaritë. Krijimi i kësaj nisme dhe kampionatet që zhvillohen ua kanë lehtësuar sadopak dhimbjen e humbjes së vëllait të tyre.

Nisma "Renato jeton", i ka zanafillat e saj 3 vite më parë, ku miqtë e ngushtë të Renatos bashkëpunonin me ata në vendlindje për organizimet, kurse këtë vit ata erdhën vetë dhe ndoqën çdo etapë të veprimtarive nga afër duke u marrë me çdo detaj të organizimit. Por le t'i përshkruaj ato me radhë. Fillimisht u organizua një konkurs pikture në shkollën 9 vjeçare "Imzot Luciano Agustini". Konkursi i vizatimit që kishte për tematikë portretin e Renato Gecit, u ndoq nga afër edhe nga piktori dhe tatuazhist mjaft i njohur edhe jashtë Shqipërisë, Albert Vathaj. Në fund u shpallën këta fitues:

Vendi i parë: Ester Gjoni

Vendi i dytë: Glenis Gjoka

Vendi i tretë: Eridona Lleshaj

Bashkia e Vau Dejës dallohet për talentet e nxjerra në sport dhe art që janë kthyer në modele dhe kanë bërë emër kudo ku kanë shkuar.

Veprimtaria kishte 3 anë kryesore të realizimit të tij. Përveç asaj artistike dhe sportive, një pikë e fortë ishte kryerja e veprimeve humane. Për këtë u mblodh një fond i konsiderueshëm, kontribuues të të cilit ishin skuadrat pjesëmarrëse në trofeun e volejbollit, por dhe e futbollit, bizneset, qytetarët e thjeshtë dhe bashkia e Vau Dejës.

Që në orën 9:00 të mëngjesit do të nisnin ndeshjet e volejbollit mes 5 skuadrave pjesëmarrëse: "Mamat", shkol-la "Imzot Lucjan Avgustini", "Shelqeti", "Vetetimati" (Naraçi) dhe "The Moon". Na bëri përshtypje sidomos njëra nga skuadrat pjesëmarrëse, e quajtur me emrin "Mamat". Jo pa qëllim ky emër, pasi për-

bërja e ekipit ishte me nëna të reja, të cilat dëshmuar se sa i zhvilluar është volejboli këtu dhe sa në formë janë ato, edhe pse rritja e fëmijëve merr shumë kohë. Tifozëria, duket se është ndarë në dy pjesë. Njëra brohoret për nënat dhe tjetra për gocat e shkathta të Shelqetit, të cilat jo pak kupa i kanë sjellë ekipit të tyre.

Nënë Fatime Çoba, ka ardhur të ndjekë nga afër ndeshjen e volejbollit ku luan edhe nusja e nipit të saj, Marina. Pas përfundimit të ndeshjes pranë saj vjen Marina. Ajo është nga Korça dhe e martuar në Laç Vau Dejës.

Emigracion këtu vijon të jetë një plagë e rëndë. Në fakt, mjafton të përmendim rastin e shkollës së mesme të bashkuar "Imzot Luciano Agustini", aktualisht sot ka 300 nxënës. Para 5 viteve ky institucion numëronte 600 nxënës. Rënia drastike e numri i tyre ka si shkak emigrimin. Janë të shumta familjet që jetojnë në vetmi të plotë, pasi të rinjtë tashmë kanë emigruar.

Është kënaqësi kur shikon qytetarë të bashkisë Vau Dejës të ndjekin nga afër ndeshjet e bukura të volejbollit që po zhvillohen këtu, çka dëshmon se kjo nismë ka zgjuar jetën e qytetit.

Për hir të së vërtetës duhet ta pranojmë se cilësia kualitative e lojtarëve të 5 skuadrave pjesëmarrëse në trofe ishte befasuese. Mesa kuptohet, që në vogëli luajnë mjaft volejball në fushat sportive të shkollave. Nga ana tjetër kjo lojë ka populllore është kthyer dhe në një traditë. Banorët thonë se në këtë shesh ku po zhvillohen ndeshjet, të investuar nga Bashkia, çdo pasdite dalin edhe nënat e reja dhe luajnë volejball. Një tregues domethënës për të kuptuar se përse luajnë kaq mirë këto skuadra.

Por le të ndalemi në aspektin human të Nismës "Renato jeton". Këtu kontribuues kanë qenë të gjithë. Përveç punës vullnetare nga mjaft të rinjë, edhe vetë skuadrat kanë grumbulluar të ardhura në emër të kësaj nisme.

Grupi organizativ, identifikoi 40 familjet më në nevojë të bashkisë Vau Dejës, ndaj të cilave shpërndau me transparencë të plotë ndihma ushqimore me një vlerë të konsiderueshme. Një pjesë e dhurimeve, është vendosur të shkojnë për fëmijët autike, për të cilët ka vite që është ndërtaur një qendër në ndihmë të tyre nga mësuesja e nderuar Alma Topalli.

Do të lëmë pas ndeshjet e volejbollit që po zhvillohen mes 5 skuadrave dhe do të ndjekim misionin human të nismës "Renato Jeton". Në fillim një ndalesë do e bëjmë në qendrën e kësaj Bashkie, pranë katedrales së "Nënë Tereza", çka identifikohet edhe me monumentin e saj në hyrje. Na habit fakti i pjesëmarrjes së gjerë në meshat e zhvilluara në këtë kishë, por nga ana tjetër është dëshmi e popullimit të kësaj bashkie, pra këtu jeta vazhdon. Qëndrimi ynë në kishë do të jetë i shkurtër, pasi miqtë e Renatos, po ngarkojnë maki-

nat me ndihma ushqimore, një veprim që po e bëjnë për disa ditë me radhë. Gjithë sasia e dhuruar për 40 familjet është e dokumentuar përmes fotove dhe filmimeve, pasi shqetësimi i tyre ishte transparenca e plotë me publikun. Ata kanë ideuar më së miri çdo detaj të këtij veprimi. Të gjitha familjet e përzgjedhura i përkasin



kësaj bashkie dhe nuk ke nevojë të shkosh shumë larg për t'i identifikuar. Ato i gjen në distanca të afërta edhe me vetë qendrën e qytetit.

Në familjen Ndreca ku jeton një nënë me djalin e saj, të rinjtë u pritën nga Aleksandri. Më tej rrugëtimi ynë do të vijojë në familjen Tusha, në lagjen "Kapedani" të bashkisë Vau Dejës. Dila preket tej mase dhe përpiket të fshehtë lotët. Ato i shkaktojnë përplasja e vuajtjeve për vite me radhë dhe një dorë që iu shtrihet. 40 familjet janë përzgjedhur në bazë të disa kriterëve njerëzore dhe kushteve reale në të cilat ndodhen. Familja e radhës do të jetë ajo me emrin Lekaj. Është tjetër gjë t'i dëgjosh hallet e njerëzve përmes statistikave apo portaleve, dhe tjetër gjë t'i prekësh ato nga afër.

Të rinjtë tanë qëndrojnë shkurt pranë familjarëve. Nuk duan që t'i vendosin ata në siklet, pasi varfëria nuk është domosdoshmërisht e lidhur përjetësisht me familjet. Ata mund ta marrin veten dhe të kenë një jetë normale. Por në fund të kësaj nisme humane, ata ndihen më të lehtësuar dhe krenar që e gjitha kjo u bë në emër të Renato Gecit. Pas shpërndarjes së dhurimeve ushqimore në familjet në nevojë, ne rikthehemi pranë trofeut të volejbollit, i cili ka nisur që në orën 9.00 dhe pritet të përfundojë në orën 18.00. Pra, kemi ardhur pranë finaleve, dhe kupa do të "rrëmbehet" nga njëra prej dy skuadrave "The Moon" dhe ajo e "Shelqetit".

Në një tavolinë vendosen medaljet për dy skuadrat dhe kupa që do t'i jepet asaj fitueses.

Pas himnit kombëtar mbahet 1 minutë heshtje në nderim të kujtimit të Renato Gecit. Fillon finalja, emocionet janë të mëdha dhe lojtaret nuk e kanë humbur energjinë e tyre edhe pse kanë orë të tëra në këtë fushë. Nga ana e tij publiku, shfaq dukshëm entuziazmin. Duhet pranuar që të dyja skuadrat qenë tepër të forta, por në fund fati i buzëqeshi "The Moon".

Ashtu siç e do tradita, të gjithë grupohen dhe mes emocioneve bëhet dhe ceremonia e dorëzimit të kupës për ekipin fitues. Fillimisht ishin lojtaret e mrekullueshme të ekipit të Shelqetit, që do të merrnin medaljet e vendit të dytë në këtë trofe. Dhe më pas, momenti final mbërriti. "The Moon" përmes emocioneve "rrëmben" kupën e trofeut "Renato Jeton".

Do të ndryshojmë disi atmosferën, pasi në kalcton e qytetit të Laç Vau Dejës do të mbahet një shfaqje përkujtimore me elemente artistike. Që në momentet e para kur qytetarët po hynin, e kuptuam përmasën e madhe që kishte marre iniciativa "Renato Jeton". Ata zgjodhën t'i bashkoheshin këtyre të rinjve, pasi ata u përpoqën për një kauzë të madhe, e cila prek çdo shqiptar, ndërtimi i të ardhmes në vendin tënd, dhe stop emigrimit që po boshatis atdheun. Është një nga ato shfaqjet e vogla në dukje, por që marrin vlerë të madhe sepse është vetë rinia që i organizon.

Finalja e futbollit do të mbahej në darkë, menjëherë pas shfaqjes përkujtimore me elemente artistike. Prej 2 javësh 10 ekupe në futboll kanë zhvilluar ndeshjet e tyre, dhe në finale u vendosën përballë dy më të fortat: "Shqiponjat" dhe "Raketat". Ndërkohë bëjmë të ditura emrat e skuadrave në këtë kampionat: "Shqiponjat", "Raketat", "Bad Lucky", "Shoqëria", "Hajmeli", "Laçi", "Laçi1", "Mjeda", "Nene Tereza" dhe "Zadrimea".

Ndeshja që në hyrje shkaktoi emocione të forta, pasi u ndoq me një disiplinë të mirë sportive, duke respektuar të gjitha pikat e rregullores, sikur të ishte një finale kombëtare. Ndeshjet, të cilat nisën me 25 shtator-8 tetor 2023 do të përfundonin pikërisht sonte, ku fitues u shpall skuadra "Raketat", pas një përballje të fortë me "Shqiponjat", ndeshje që u shoqërua nga një tifozëri mjaft e mirë dhe entuziaste.

"Renato Jeton", nisma e cila gjeti mbështetje nga rinia, qytetarët, bashkia e Vau Dejës, ia arriti qëllimit të saj. Jeta duhet ndërtaur në atdhe. Të rinjtë, miqtë e Renatos treguan një shembull të mirë duke dhanë një kontribut të vyer, që nga shembulli personal e deri tek bashkimi i tyre që frymëzoi me dhjetëra të rinj e te reja jo vetëm në këtë bashki.

KOZETA BRUÇI

TË NJERKËS DHE PA BABË!

Veriu i Shqipërisë është pjesë e territorit të R. SH. pra brenda 28 748 km².

Historiku i Veriut është model për virtytet e larta që e karakterizojnë. Ashtu si në të gjithë Shqipërinë besa, bujaria, trimëria janë cilësi të popullit tone. Sot Veriu i Shqipërisë përbëhet nga katër qarqe me një popullsi rreth 600 mijë banore. Për Veriun e vendit tone kanë shkruar historian të shquar Evropian e Botëror.

Ne, nuk po merremi me historikun e këtyre trevave, se duhen volume të tëra. Po ndalemi tek përfaqësimi që i bëhet në pjesëmarrjen në Qeverinë e vendit, në investime, në arsim, kulturë shëndetësi e të tjera.

Të kthehemi prapa në histori. Në qeverinë e pas Shpalljes së Pavarësisë, në qeverinë e Ismail Qemalit. Shqipëria përfaqësohej në proporcion të drejtë në mes trevave, besimeve fetare e të tjera. Nga 11 ministri që kishte kabineti qeveritar ishin të ndara në proporcion të drejtë. Kryeministër dhe ministër i punëve të jashtme ishte Ismail Qemali, Z/ kryeministër ishte Dom Nikolle Kaçori. Në këtë proporcion ishte edhe ndarja e kabinetit qeveritar. Thënë troç, përfaqësimi ishte në proporcione të drejta në Shqipërinë e Jugut, të Mesme dhe të Veriut. Po të njëjtën gjë, mund të themi edhe në qeverisjen e mbretit Zog. Në diktaturë mbase një farë bilanci në përfaqësim ndonëse minimale. Duke marrë shkas nga një intervistë e dhënë, nga Muho Asllani, ish drejtues i lartë në periudhën e diktaturës. Në një televizion, duke folur për tërmetin e 15 prillit të vitit 1979, i cili preku shumë rendë Shkodrën e Lezhën. Mbase jo në ligjërate të drejtë, po në thelb ishte ky: Gjatë gjithë kohës rindërtimit e gjithë shteti ishte vendosur në këto rrethe. Madje vet Enver Hoxha kishte qëndruar shumë ditë në Shkodër. Në një udhëtim

për në Bajzë me Muho Asllanin i thotë: U bëra Shkodran, përgjigjen e mori në moment. Shumë mirë do ishte se ne shkodranët jemi të përfaqësuar në asnjë Ministri apo drejtori qendrorë. Flakë për flakë i thotë bane një listë, kush e meriton e ma sjellë mua, po nuk më takove mua dërgoja Hysniut. Nuk vonuam dhe lista u bë, shumë shpejt u emëruan disa shkodranë në poste të rëndësishme. Përshtypje të bënë. Urdhri i dhënë direkt nga Enver Hoxha ishte që shtëpitë e ndërtuara të behën me parametra të njëjta pa dallim klasor.

Ndërsa sot po nuk votove rilindjen nuk të lënë aktivistët të punësohesh. Punova rreth 20 vite në Tropojë, gjej rastin të përshëndes të gjithë Tropojanët, për mikpritjen dhe respektin që kanë treguar për kuadrot jo vendas. Për sa i përket përfaqësimit në strukturat drejtuese të rrethit të Tropojës, mbase një bilanc në mes krahinave, konkretisht: Nga zona e Nikaj-Merturit përfaqësoheshin nga një sekretar i Komitetit Partisë, dhe në ekzekutivin përfaqësohej nga n/Kryetari ose sekretari i Komitetit Ekzekutiv.

Të ndalemi te qeveria "Rama -3". Nga katër qarqe të veriut, Shkodra, Kukësi, Lezha e Dibra, nuk përfaqësohemi vetëm me një Ministër. Popullsia e këtyre qarqeve është rreth 600 mijë banore, sa një e katërta e popullsisë të gjithë vendit. Nuk mund të habitesh kur Shkodra kishte një Ministër. Për të mos u larguar të bëjmë një krahasim me Republikën e Malit Zi. Shqiptarët janë mbi 45 000 banor dhe në kabinetin qeveritar mbajnë tre poste ministrore, njeri prej tyre është edhe z/Kryeministër.

Lind pyetja përse?

Përse ky mos përfaqësim në qeveri nga këto treva?

Po të kthehemi shumë prapa në his-

tori, duke u ndal te Shkodra, Shkodra është shpallur qytet 4 shekuj para lindjes Krishtit. Në shekullin e XVII kishte zhvillim të lartë për kohën, ekonomik, arsimor, kulturor e të tjera. Zhvillim të vullshëm kishte marrë zejtaria, tregtia dhe numëroheshin mbi 2500 dyqane. Nuk është rastësi në Shkodër janë ndërtuar fabrikat e para, si fabrika e çimentos, vajit, sapunit, e të tjera. Katër qarqe nuk paskan mundësi intelektuale të kishin në kabinetin qeveritar të paktën tre - katër Ministra? Sa e sa figura të shquara kanë dal nga këto treva, të pendës e të pushkës, duke mos u përfaqësuar në qeveri, pra duke mos pasur kush të ngre zërin. Fondet për investime janë minimale, qoftë edhe ato të pakushtëzuara. Sa herë është folur për rrugën Milot- Balldre dhe ende nuk ka filluar. Sipas premtimeve duhet të ishte përfunduar para dy viteve. Po të njëjtën gjë mund të themi për rrugën e Arbrit, e cila është inauguruar disa herë dhe ende është gjysmake.

Duke u ndal te buxheti i vitit 2024, përsëri Veriu i Shqipërisë shihet me syrin e njerkës. Janë planifikuar fondet e pakushtëzuara 35 miliard lek me një rritje të konsiderueshme prej 16 për qind, në krahasim me vitin 2023. Po çfarë ndodh, Vorës planifikohen 20 për qind, Tiranës 19.5 për qind, Mbi mesataren në shkallë vendi. Janë planifikuar me 17 për qind, bashkive të Këlcyrës, Delvinës, Pustecit, Patosit, Peqinit, Dropullit, Roskovecit e të tjera. Bashkive të Veriut u janë planifikuar nën mesataren në shkallë vendi me 14.5 për qind.

Qeveria bie në kundërshtim me veten, se në fushatë elektorale është thënë se kush nuk voton rilindjen nuk do të mbështetet me fonde. Shkodra për herë të parë në këto vite në demokraci votoi majtas. Përsëri mbështetja është e

njëjtë. Nga e thëna në të bërë i ndanë një det i tërë thotë populli.

Vendimi i KM 20/20 doli për pajisjen me certifikata pronësie të gjithë banorët e zonave malore. Këto sipas kufijve të trashëguara nga gjyshërit e stërgjyshorit. E thënë më troç, sipas kufijve të vjetër. Po të njëjtën gjë tha edhe për legalizimin e shtëpive të ndërtuara para viteve 1990. Njëzet u dyndën për të plotësuar dokumentacionin sipas vendimit të cituar më lart. Pati shpenzime në para dhe në kohë, por asgjë nuk ka lëvizur në këtë drejtim. Me qindra mijëra turist vizituan Vermoshin, Thethin, Lumin e Shalës, Valbonën e të tjera, e të tjera. Gjasat janë se vitet e ardhshme ky numër do dyfishohet. Për t' i përballuar kërkohen shtimi i kapaciteteve pritëse, duhen bujtina. Të behën ndërtime duhet pajisur me leje, të marrësh leje duhet certifikatën e pronësisë!!! Të ndërtosh pa leje, shkel ligjin dhe përfundon në burg. "Hip në fik se të vrava, zbritë nga fiku të vrava!"

Ka me qindra raste të shitblerjes tokës në këto zona me letra dore, pa asnjë bazë ligjore. Për veç asaj që një ditë mund të pendohen si shitësi edhe blerësi. Raste, të cilat urojmë të mos përfundojnë në ngatërresa e deri në humbje jetësh. Këto shitblerje bëhen me leke në dore, pa kaluar në banka, duke rritur in formalitetin.

Mendoj se ka ardhur koha, të ngrihem ashtu siç u ngritëm me moton: "Dukagjini kërkon rrugën!"; të ngrihem përsëri me moton: "Malësia kërkon tapitë!"

Shpresojmë që AMP të bëjë sa ma pare legalizimin e banesave dhe dorëzimin e certifikatave të pronësisë sipas vendimit të cituar më lart.

Përsëri shtroj pyetjen: Kur do bëhemi të gjithë të nenës? Cilat janë detyrat tona? Kërkuat votat i morët edhe sa duhet me prit? Pritja ka një kufi!

Përgatiti NDUE ZIÇI

*** POEZI nga Tahir Bezhani *** POEZI nga Tahir Bezhani ***

MREKULLIA E ÇATISË....

Nuk është dije apo mrekulli
Të mbarosh shtëpi që ëndërron
T'i gdhendësh trarët me durim
E t'i lidhësh me gozhdë përmbi
Sado së bashku të bëjnë dashuri
Jetë e dhunshme i thonë
Jetë nën gozhdë, me tradhti....
E sa kohë të gjatë do të ketë vlerë

Skalitja e dy drunjtëve faqesh bardhësi
Me një gjen të lindur, rritur në bashkësi
T'i pëlqesh "gojë-gojë" me mjeshtëri
Nuk mbajnë mes vete zili...

Kalimtarët ua kanë lakmi
Si kullave ilirike në trojet etnike
Edhe tërmetet hamenden
Kur luajnë lojën me dredhi...


ATY TE BLINI

Aty
Te "Blini i Poetit" në Pejë
Pranë atij druri të plasur kohe
Kafeja e mëngjesit avullonte
Radhazi ngrohtësisht shikonim njëri- tjetrin
Hurbnim lëngun, tjerrshim llafe
Buzagazet jehonin syprinës së valëve
Lumëbardhi buzëqeshte me krenari
Ecte me vrap ,bënte rrugëtimin e tij
Sejdi Berisha ngjante në përmendore
Mbante në dorë një fletë të bardhë e lapsin e zi
Radhiteshin fjalët, shkruante poezi
Për njerëzimin e kohët nxira moteve
Në zemër vargu rrëfente qëndresën,
Mbillte dashuri për brezat
Për fushat e malet,
Për këtë tokë të gjakosur...

Kur lapsi mbaroi ngjyrën e tij
I nevrikosur poeti tha:
Miqte e mi
"Shikojeni këtë stilolaps
Do e hedh në Lumëbardhë

Të mbetët si hieroglifë

Le t'i pëshpëritë vargjet e zemrës sime
Dëshmi jete e kam këtë Bli!...."
Lala e Nekiu qeshen me xhelozi,
Luli nuk ishte atë ditë mes nesh
U ndjeva i dërmuar mes vargjesh si tunxh
Admiroja atë burrë e vargun e plastë të tij
"Rrofsh sa Blini i thash!..."
Ika, e lash varur në vargun brilant
Aty te Blini,
Mbolla kujtimin e gjatë për stilolapsin
Për vargun e tij.....
Pejë, 23.tetor 2023



Bashkëbisedimi me Profesor Ibrahim Hajdarmataj, dhanë Radio-Televizionit të Kukësit

Zoti Ibrahim, ju keni punuar në arsim rreth 6 dekada dhe tani jeni në pension, a mund të na thoni diçka nga filimet e punës tuaj?

Unë kam mbaruar pedagogjiken 2 - vjeçare "Tre Heronjtë" në Shkodër me Gjovalin Shkurtin, i cili filloi punën e mësuesit në fshatin Tale të Lezhës dhe unë në Zogaj të Tropojës, ishim mësues 15 vjeçare. Gjovalini vijoi studimet e sot është Prof. Dr. dhe Akademik, unë arrita deri drejtor gjimnazi.

Krahina e Bytyqit kishte 3 shkolla fillore Zogaj, Kam, Berishë dhe 7 - vjeçarën në Pac, ku bënim mbledhje dhe kishim vartësi.

Më thirrin në Pac për një orë shembullore. Shkojë e futna në drejtori. Pas pakë vjen drejtori e me autoritetin e tij, i bërtet kolegut "Të kam thanë se nuk dua nxënës në drejtori?". - Kolegu i thotë me zë të ulët, është mësuesi i Zogajve.

Atëherë drejtori më drejtohet, ti je mësuesi i Zogajve? - Po i themi, ke mbarua shkollën 7 - vjeçare ti? Po i them (nga trupi isha më i vogël se nxënësit). Mirë, mirë belbëzojë drejtori. Filloj mësimi shembullor.

Një mësues, i cili jepte mësim, ishte flokë bardhë rreth të 60-ve, me arsim fillor dhe një kurs për mësues 9 - mujor. Pasi mbaroi mësimi filloi analiza. - Kolegët e tij ishin me fillore, 7-vjeçare e kurse pedagogjike. Kur fillojë analiza, njeri i thotë: "Të lumtë pyka e ke tha këtë orë mësimi!". Tjetri i thotë: "E kemi dite, por ka ditë që nuk të kemi dëgjua kaq mirë...!"

Vijuan diskutimet, me shumë lëvdata për mësuesin, ndërsa analiza e mësimit nuk po behej.

Në këto çaste drejtori më drejtohet, çoji ti mësuesi i Zogajve e na thuaj çka mësove nga kjo orë mësimi?

- Çohem unë dhe them se nga kjo orë mësimi nuk mësova asgjë. Fillova unë duke folur se si etapat pedagogjike duhet të ndjekjen në orën e mësimi....

Një heshtje e paparë. Drejtori mu drejtua përsëri. - Ju çfarë arsimimi keni? Pedagogjiken 2-vjeçare, i them. - Edhe unë jam me Pedagogjike 2 - vjeçare, të lumtë për analizën e mësimi, të gjithë duhet të merrni shembull çka tha Ibrahim.

Tani eja pranë meje, dhe tani e tutje do të jesh z/drejtor.... Jo, jo i them, se Zogaj me Pacin janë rreth 30 km, se bëj dot. - Kështu filloj jeta e ime në arsim.

Po me nxënësit në Zogaj a keni ndonjë mbresë?

- Duke vijua shkollën me korrespo-



dencë, pedagogjiken 4-vjeçare "Shejnaze Juka", Universitetin shtetëror degën gjuhë - letërsi, punoja mësues në arsimin e detyrueshëm, pastaj në gjimnaz, z/drejtor dhe më vonë drejtor.

Më kujtohen vitet e para si mësues:

Nga fundi i bankave një nxënës, gjatë orës së mësimi, që po ligjëroja, vetëm qeshte.

I them të ngrihet në këmbë dhe të vinë te dërrasa e zezë.

I afrohem dhe i them pse qeshë...?

Ai skuqet në fytyrë, më fal zoti mësues. I afrohem me afër, ishte më i gjatë se unë dhe ja jap një shpullë, por pak e preki fytyrën e tij. Ai ul kokën që unë ta qëlloj më mirë. Unë e qëlloj me gjithë forcën që kisha. Ulu i them dhe të mos ta dëgjojë zërin. Ai ulet dhe fillon ti dalë gjak nga hundët, i cili e mbulon me duar.... Pas mësimi mora rrugën për tek shtëpia e nxënësit. U pa puna! Unë do të zihesha me malësorin tim, babën e nxënësit, ku

do ti kërkoja falje. - Pasi u përshëndeta me prindin, i tregova thjeshtë se djali i juaj ka prishë qetësinë në orën e mësimi.

- Ai e thirri djalin dhe ju vërsul që ta rrahin, duke belbëzuar kërkojë falje mësuesit për shqetësimin. Djali filloi të dridhet dhe tha më fal zoti mësues se, kurrë nuk do ta prishi më orën e mësimi. Ky

nxënës u bë baba e gjyshe dhe sot më thërret mësues Ibrahim. - Ndërsa sot po ti thuash nxënësit, se je duke u sjellë keq në orën e mësimi "o i paedukatë", nxënësi të incizon, filmon dhe thotë se mësuesi më uli personalitetin në orën e mësimi, prindi thotë, se u shkelën të drejtat e njeriut....

Ju vijimisht shkruani në shtypin e ditës, keni botua edhe libra, a mund të veçoni ndonjë gjë?

Po krahas detyrës së mësuesit nuk ju kam ndarë edhe të shkruarit në gazeta. Shkrimet e para kanë qenë në gazetën "Mësuesi", në të cilën ishte kryeredaktor Bedri Dedja Prof, Dr dhe Akademik. Pra, unë jam nxënës i Bedriut. - Fatkeqësisht sot gazeta "Mësuesi" nuk botohet, ndoshta Ministria e Arsimit do ta korrigjojë, siç i ka korrigjuar gabimet në vite. - Gjuha shqipe nuk bëhej në gjimnaze, vetëm vitet e fundit është futur si lëndë.

Po kështu edhe lënda e psikologjisë ishte hequr dhe tani është futur përsëri.

Bashkëpunimin sot e kam me revistën shkencore "Perla", "Universi", me gazetën "Telegraf", "Nacional", "Gazetën e Alpeve", "Kushtrim Brezash", gazetën "LISSALBA" dhe unë do të ndalem kryesisht te Gazeta "Dukagjini". Gazeta mujore e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me qendër në Shkodër, me drejtues ushtarakun, Kolonelin në Pension, gazetar dhe publicist Ndue Sanaj, i cili drejton me mjaft përkushtim shoqatën e mirënjohur "Dukagjini" dhe në saj të punës së tyre, zona e Dukagjinit, është dekoruar me dekoratën e larte "Nderi i kombit" dhe kryeredaktorja e kësaj gazete, intelektuala Klodiana Serraj, e cila është e mirënjohur nëpërmjet kësaj gazete, na jep jetën e gjalle dhe veprimtarinë kryesisht të Shqipërisë së Veriut.

- Kjo gazetë lexohet me vëmendje dhe me shumë konsideratë, sepse gazeta "Dukagjini" publikon vetëm e vetëm të vërtetën!

Ju kemi borxh 28 mijë dëshmorëve që dhanë jetën që gëzojmë sot ne, në vendin tonë të lumtur, për ti përkujtuar ata dhe pasardhësit e Veteranëve. Unë, duke e pasur babën edhe nënën partizan të Brigadës 25 Sulmuese Tropojë (Ukën dhe Xhemilen) dhe gjyshin, shok arme të Bajram Currit (Arifin), i cili ka qenë i dënuar 101 vjet burg, na del për detyrë që heroizmi i të parëve tanë ti përgjithësojmë vlerat e tyre.

- Po, po, e thatë bukur se edhe unë si gazetare e Radio-Televizionit Kukës nga Gazeta "Dukagjini" me faqen letrare e shumë nga shkrimet e tyre i kam kaluar në emisionet e mia të Radio-Televizionit të Kukësit sidomos për LANÇ dhe rubrikat për traditat.

Përfundimisht, ju falënderoj për bashkëbisedimin!

Faleminderit juve, i nderuar Ibrahim!

Bashkëbiseduesja, gazetarja AIDA MUJA

U nda nga jeta – Nike Gjon Nika (Gjonaj)

Me 8 Nëntor 2023, dite e mërkurë u nda nga jeta në moshe 94-vjeç.

Nike Gjon Nika (Gjonaj) nga Breg - Lumi Nicaj -Shale, Dukagjin.

Ai ishte një nga burrat në zë të Dukagjinit dhe me gjere.

Lindi me 4 Maj 1929.

I Ati, Gjon Nika me tradita patriotike atdhetare, fisnike e bujare në zë në gjithë trevën e Dukagjinit. Nena e tij, Lena Dede Mhilli (Guri) nga Brashta e Shoshit edhe ajo një familje me zë për atdhetarizëm, patriotizëm, për buke, për bese dhe burëri.

Ai ishte një burrë me pak shkolle, por

me shumë dije e aftësi, një burrë i mprehte, "brisk" në gojë dhe shumë i rrepte, me të cilin nuk mund të përballëj kushdo, cilësi që pati nga ti trashëgonte, si nga familja e tij, ashtu dhe në tervezat e burrave Dukagjinas më në zë të Nicajve e Pecajve të Shalës, të Shoshit, Kirit, Xhanit e Planit, të Toplanes, Shllakut e Temal -Dushmanit .

Nike Gjoni arsimin fillor e mori në Abat gjate regjimit të Ahmet Zogut, ndërsa shkollimin 7-Vjeçar e kreu në moshën 32-vjeç në vitin 1961, në Breg-Lumi pa shkëputje nga puna, sepse përveç dëshirës që kishte për shkollimin, i duhej të kryente së paku shkollimin 7-vjeçar çdo anë-

tari apo kandidati partie.

Nika, që në fëmijëri dallohej si gojëtar i jashtëzakonshëm, me cilësi e aftësi të radha, i ditur, trim e atdhetar, që munde të matej në kuvende burrash, gju më gju, pa iu trembur syri dhe pa i rene poshtë fjala asnjëherë nder takime apo pleqëri.

Ai ishte i papërkulur dhe shumë i prere me këdo që debatonte.

Gjate regjimit të Ahmet Zogut dhe luftës Nacional-Çlirimtare, si çdo malësorë provoj vuajtjet dhe fitoi përvojën e një aktivisti të dalluar si pionier antifashist.

Kur ishte vetëm 14-15 vjeç në vitet



1943-1944 u pranua në rininë Komuniste antifashiste shqiptare, duke u rreshtua në rrallët e luftës Nacional-Çlirimtare. Ai u zgjodh Kryetar i Rinisë Antifashiste të fshatit Nica dhe në vitin 1945, në moshën 16 vjeç u zgjodh Sekretar i Rinisë Komuniste për krahinën e Shalës, që më vonë u quajt Bashkimi i Rinisë Punës Shqipërisë (B.R.P.SH). Me 5 shtator 1947, në moshën 18 vjeç u pranua në Partinë Komuniste Shqiptare, duke qene nder komunistet e pare në Shale. Ai, me 4 delegat nga jugu i Shqipërisë, ishin 5 delegatet e pare të Partisë Komuniste në Shalë.

Në dhjetor 1947, Nika u zgjodh Sekretar i organizatës së partisë, për krahinën e Shalës.

Në vitin 1948, kur ishte 19 vjeç Nika u zgjodh Kryetar i Lokalitetit për krahinën e Shalës, me qendër në Abat, si dhe Sekretar i organizatës së partisë i lokalitetit, si një i ri me aftësi të radha gojëtarie e merita pune e drejtuese.

Në vitin 1950, në moshën 21 vjeç u emërua përgjegjës i grumbullimi në Shkodër. Në muajin tetor 1950 u thirr për të Kryer Shërbimin Ushtarak, në Repartin Nr.6543 Gjirokastrë, në Batalionin Special të instruksionit një vjeçar të përgatitjes të Specialisteve ushtarak, për Forcat e Armatosura të Republikës të Shqipërisë, në të cilin mori gradën e Nen oficerit, për përgatitje të larte ushtarake e politike. Aty qëndroi edhe 2 vjet, në detyrën e instruktor, për përgatitjen e nen oficerëve për Divizionin e Gjirokastrës dhe të Jugut Shqipërisë.

Në shtator të vitit 1952, Nika u dërgua në Durrës, në shkollën e oficerëve, që pas

tre muajve mori gradën e Aspirantit.

Në janar të vitit 1953, Nika mori gradën Nëntoger dhe u diplomua shkëlqyeshëm, në detyrën e Oficer Rezerve, me 15.02.1953.

Pasi mbaroi shërbimin ushtarak, në shtator të vitit 1953, merohet shef i seksionit të financës për rrethin e Dukagjinit ku punoi për 6 (gjashte) muaj.

Nga viti 1954 deri në vitin 1956 punoi në detyrën e prokurorit të rrethit të Dukagjinit dhe kandidat të Komitetit të Partisë të Qarkut Shkodër, që në këtë kohë Sekretar i Pare, ishte Adil Çarçani dhe më vonë Sadik Bocaj.

Mbas suprimimit të rrethit të Dukagjinit, me qendër në Kodër Shëngjergjit dhe kalimi me rrethin e Shkodrës dhe duke u bere Dukagjini lokalitet, nga viti 1956 deri në vitin 1958, Nika punoi instruktor i Komitetit të Partisë i rrethit Shkodër, për lokalitetin e Dukagjinit e Shllakut.

Në vitin 1958 deri në vitin 1960, Nika punoi llogaritar i spitalit të Dukagjinit, të ndërtuar me mjeshtëri guri të latuar, nga mjeshtri më të mirë të Dukagjinit, në vitin 1952, të cilit populli i këndoi atëherë: "U ba spitali në Breg të Lumit, / mjaft i mirë gurit e drurit / ...".

Në vitin 1960, Nika u martua me Sose Sokol Marash Doden (Logun) nga Celajt e Ndreaj-Shoshit, me burrneshën, që kundër mentalitetit të kohës, te dy e zgjodhën vete njeri-tjetrin dhe kane 5 fëmijë, tre djem dhe dy vajza, të cilët sot punojnë dhe jetojnë shumë mirë, tre janë jashtë vendit, ne Itali dhe dy të tjerë në Dobraq- Shkodër, duke mos harruar edhe



Dukagjini.

Nga viti 1959 deri në vitin 1967, Nika punoi në detyrën e Kryetarit të Zyrës P.T.T (Poste-Telefon-Telegrafë), në qendrën e Dukagjinit.

Në vitin 1961, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare (PKSh), Nika u nderua nga Gjeneral-Major Spiro Moisiu e Shoqata SHNUN, për pune të mirë e të palodhur.

Në vitin 1968 u dekorua nga Presidumi i Kuvendit Popullor, me 'Medaljen e Punës' për shërbime e organizimin e Kooperativisteve, për elektrifikimin e gjithë fshatrave të Dukagjinit me 16 Tetor 1968.

Në janar të vitit 1967, me Krijimin e Kooperativave bujqësore në të gjithë Dukagjini, merohet Kryetar i Kooperativës bujqësore në Toplane, për një vit, ku edhe unë punoja në arsim mësues Histori-Gjeografi, në shkollën 8-vjeçare.

Nga viti 1968 deri në vitin 1978, Nika

punoi Kryetar i Kooperativës bujqësore në Shalë, përgjegjës sektori në fshatin Gimaj dhe llogaritar kooperativë, në këto detyra nuk i ka munguar kërkesa e llogarisë ndaj vetes, të tjerëve dhe rezultatet e mira nuk kane munguar.

Nga viti 1979 deri në vitin 1989, Nika punoi në ndërmarrjen shtetërore gjeologji-Miniera, në detyrën e sondist.

Nga vitet 1960 deri në vitet 1980 ishte edhe oficer rezervist, në detyrën e Komisarit të batalionit sulmues, me qendër në Zallin e Camajve të Bregut-Lumi. Në vitin 1989, Nika doli në pension.

Nike Gjoni kudo që punoi, në çdo detyre punoi me disiplinë, me përkushtim e profesionalizëm, i afte në pune e i rrepte në detyre, i ftoftë si akulli në mendime, por edhe i nxehte si prushi ndaj padrejtësive e së keqes, i matur në fjale e mendime dhe i prere e këmbëngulës dhe i palëkundur në gjykime e veprime.

Me ndarjen e tij nga jeta, me 8 Nëntor 2023, pa e lanë këmba e as dora, as syri e as veshi, mendja e as fjala.

Familja humbi –Prindin e dashur të shumë të ditur e të rrepte!

Breg-Lumi-Nica dhe Peca Shale –Gojëtarin e pashoqe të fjalës së mprehte!

Shala dhe Dukagjini Burrin e ditur, trim dhe të vendosur të mendimit të pavarur, i cili nuk do të harrohet nder breza! Ngushëllime të gjithëve!

I përjetshëm emri e Kujtimi i Nikë Gjoni!

Lamtumire – Kumbara i dashur!

Lamtumire Dajë!

Të nderuar pjesëmarrës!

Me hidhërim të thelle, po i japim lamtumiren e fundit babit, gjyshit, madje edhe stërgjyshit (16 here), vjehrrit, dajës, kushëririt, familjarit model, bashkëqytetarit të kulturuar, kolegut dhe intelektualit të shquar, mësuesit dhe drejtuesin pasionant, pleqnarit të zgjuar, veteranit të luftës, mikut, shokut dhe dajës tim të dashur Mirash Zef Ndreza.

Mirash Ndreza lindi në vitin 1926, në fshatin Vuksanaj, të krahinës së Shalës, në një familje të përmendur për tradita Atdhetare, fisnike e bujare. Ai u rrit, u edukua dhe u burruar me këto tradita, të cilat me përkushtim ua transmetoi fëmijëve të vet dhe brezave të shumte nxënësish në zonën e Dukagjinit.

U rrit dhe u edukua në një familje të madhe patriarkale, me 3-4 breza, në të cilën kishte marrëveshje, mirëkuptim, harmoni, respekt për njeri-tjetrin, dëgjohej e respektohej fjala e të zotit të shtëpisë, secili pjesëtar i familjes kryente punën e caktuar. Kjo beri, që të siguronin mirëqene pa ja shtri kujt dorën.

Ishte ky mjedis i shkëlqyer familjar për kohën, fale talentit e zgjuarsisë natyrore të babait të Mirashit, Zef Shytani, i përmendur në Shalë e Dukagjin, si mendimtar e

zot shtëpie i suksesshëm, në gjurmët e të cilit eci edhe djali i tij, Mirash Zefi.

Mirashi, është nder mësuesit e pare të Dukagjinit dhe i pari mësues i shkolluam në Shalë. Ai, në moshë të vogël u dallua për zgjuarsinë, iniciativën, kurajën e vullnetin e pa epur për pune, besim në vetvete, kërkues ndaj vetes, për të arritur më të mirën e mundshme.

Me shumë vështirosi e sakrificat arriti të shkollohej.

Shkollimin 7-vjeçare e të mesëm i kryen në Tiranë dhe të lartit, në degën Biologji –Kimi, në qytetin e dijes e kulturës, në Shkodër.

Pas mbarimit të shkollës shërbeu në detyrën e shenjtes të mësuesit dhe drejtues në Toplane, Gimaj, Xhan, Palaj, Ndreaj, Abat dhe Vuksanaj. Punoi me pasion e përkushtim, u dallua për devotshmëri dhe ndërgjegje të larte, krijoi marrëdhënie të ngrohta dhe miqësore me bashkësinë e nxënësve, prindërve dhe kolegeve. Këto arritje në shkollim e punë i realizoi me vështirësi e pengesa të shumta, sepse regjimi komunist, nëpërmjet disa individëve, servil, pa moral, pa dinjitet njerëzorë, pa vlera, inatçarë, të sëmure e spiunuan, paditën, shkruan letra, shpifën e të tjera, duke e akuzuar me të pa drejte dhe për pasoje u pushua 2-3 here nga puna, por

ishte me kuraja, guximi, me besimi në të drejtën e Zotit, besimi në vërtetën, vullneti, këmbëngulja e durimi i tij, që në të gjitha rastet triumfoi dhe doli fitimtar mbi padrejtësinë dhe injorancën, duke u rikthyer në punë. Merita e tij qëndron në faktin, se kurrë nuk zgjodhi rrugën e hakmarrjes primitive ndaj keqbërësve, por rrugën e paqes, drejtësisë sociale e dinjitetit njerëzorë.

Nder, respekt e mirënjohje për vlerat tuaja njerëzore Mirash Ndreza!

Mirashi krahas punës në detyrën e shenjtes të mësuesit u dallua veprimtaritë shoqërore, e donte dhe ju përkushtua shumë vendlindjes.

Mirashi, ka njohur shumë mirë traditën, kanunin e Leke Dukagjinit, por intelektual ka njohur edhe legjislacionin. Me mjeshtri e zgjuarsia ka gërshetua traditën me bashkëkohoren, ka njohur psikologjinë dhe temperamentin e dukagjinasit.

Në personalitetin e tij ishin mishërua cilësi e virtyte morale njerëzore: dashuria, drejtësia, barazia sociale, ndershmëria, besimi në Zotin, asnjëherë në gjykim, papajtueshmëria me të keqen, ndërgjegjja e larte, transparenca, humanizmi njerëzor e të tjera. Bazuar në këto virtyte e vlera morale, u përzgjedh nga njerëz të ndryshëm pleqnarë, për të zgjidhur probleme e mosmarrëveshje midis familjeve të ndryshme, nga më të voglat deri në pajtimin dhe faljen e gjakut, duke parandalua krime në Shale, Shosh, Nikaj, Mertur, Toplane e Shkodër.

Një vlere e veçante e Dajës Mirash ka gene dashuria, respekti dhe kujdesi për

familjen, gjakun e tij të shtrire gjeografikisht në Shale, Shosh, Toplane, Nikaj, Mertur, Bajram Curri, Laç, Tiranë, Lezhë, Shkodër e në vende të tjera.

Në çdo kohe, pavarësisht punës së shtetit, në detyrën e mësuesit, detyrimeve familjare, Ai, gjithmonë ka gjetur kohën për të përjetuar problemet, shqetësimet dhe gëzimet e njerëzve të tij, na ka mbështet e ndihmuar në çdo rast të gjithave. E për këtë do ta kujtojmë gjate, i jemi mirënjohës. Na ke lanë shumë gjera të çmuara, plot kujtime të bukura, të cilat nuk do ti harrojmë asnjëherë. Ti do të mbetesh gjithmonë i gjalle në mes nesh, në mendjet dhe zemrat tona.

Dajë po shkon kryelarte në jetën e pasosur, sepse keni lanë trashëgimtare të denje e të devotshëm, djalë-Sokolin, vajza, nipa e mbesa të afte, të cilët janë vetvetja, janë shkollua, punësua, kane biznese, kane sigurua të ardhura e mërqinjë, duke qene shembull për mirë në mjedisin ku jetojmë, ashtu si i mësove, i edukove siç dëshirove ti.

Ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes, të afërmeve, miqve dhe dashamirësve!

Zoti ju dhishtë forcë, për të përballuar dhimbjen dhe për të pare përpara!

Lamtumire daja im i dashur!

Pushofsh në paqe!

I paharruar qofte kujtimi I Mirash Ndreza!

NDUE DOSHI,

Shkodër, me 05-12-2023

Pse nuk duhet të vrasë njeriu?

Në vitin 1984, gjenerali gjerman, Keissling, shkaktoi një "ciklon" në politikë, psikologji dhe filozofi, me thënien e tij se: "Gjithashtu, një ushtar i Ushtrisë së Kuqe sovjetike, është vëllai im. "Cikloni" përfshiu edhe komandon e NATO-s në Bruksel. Sa i përgjegjshëm dhe i ndërgjegjshëm ishte gjenerali për thënien e tij!? Normalisht, nëse një ushtar tregon dashuri për armikun dhe e mendon atë vëlla, duhet larguar menjëherë nga radhët e ushtrisë. Ai nuk është aspak i gatshëm ta vrasë armikun, nëse do t'i duhet ta bëjë këtë. Për rastin e gjeneralit, u mendua se, një arsye e brendshme, e shtyu atë aq larg, sa deklaroi atë që një gjeneral, kurrësi nuk duhet ta deklaronte. Edhe një ushtar, jo.

Gjenerali, megjithëse ishte bërë gjeneral për të vrarë dhe paguhej për të vrarë, nuk donte të vraste. Sepse morali i tij nuk ia lejonte këtë. "Mekanizmi vrasës", atij nuk i funksiononte. Ashtu si dhe dhjetëra burrave të batalionit 101.

Megjithatë, a është çdo njeri i pajisur me "mekanizmin vrasës" dhe si funksionon ai? Fjala është: a duhet të vrasë njeriu?

Kristina, 40 vjeçe, pyet: "A duhet ta vras unë xhaxhain tim, Thomain apo ai duhet të vazhdojë të jetojë?"

Kush është Thomai?

Thomai është një burrë, rreth të shtatëdhjetave dhe i shëndoshë si kokrra e mollës. Një burrë, që gjithë jetën e tij ka tiranizuar njerëz. Edhe vëllain e vet, babain e Kristinës. Kush nuk ka vuajtur nga ai. Të afërm, komshinj, të njohur dhe të panjohur. Gjithkush që ka pasur fatin e keq të ketë të bëjë ose të takohet me atë. Është martuar pesë herë. Tri gra i ka "ngrënë" për së gjalli dhe dy i ka ndarë. Ka pasur dy djem dhe që të dy, me dallaveret e tij, ua ka nxjerrë të tjerëve në pritë dhe i kanë vrarë. E gjithë jeta e tij është vetëm konflikte. Kush nuk e ka vrarë atë, me mend, sa dhe sa herë. Edhe Kristina. Ndoshta me dhjetëra herë. Ai është i pasur, shumë i pasur. Me ndërrimin e sistemeve, brenda pak viteve, ai u bë shumë i pasur. Bëhet fjalë për miliona. Trashëgimtarja e vetme është Kristina. Me kujdesin që ai tregon për jetën e vet, duket sikur nuk ka ndërmend të vdesë kurrë. E vetmja gjë që atij i intereson, janë paratë. Nëse ai vdes në moshën 90 vjeç, unë atëherë jam mbi 60, mendon Kristina. Kush mund ta dijë se, edhe nëse i marr milionat e tij në këtë moshë, mund të më hyjnë në punë. Nganjëherë i uroj xhaxha Tomit të vdesë që nesër. Përse nesër? Që sot. Pastaj bëhet pishman. Përse duhet të vdesë ai!? Përse duhet ta vras unë? Vetëm që të përfundoj konfliktin me të? Utilitarizmi filozofik nuk ia lejon këtë.

Jeremy Bentham (1748-1832), themeluesi i utilitarizmit filozofik, u lind në Londër. Ai ishte liberal, pacifist dhe mbrojtës i mendimit të lirë.

Dëshira e babait të tij, i cili ishte shumë i pasur, ishte që ai të bëhej avokat. Bentham studioi për avokat, por në jetë nuk u bë i tillë. Ai ëndërronte njeriun, jetën dhe liritë e tij. Iu përkushtua së drejtës civile, reformës sociale, mendimit të lirë, për-

mirësimin të jetës në burgje dhe mbështeti lëvizjen e parë të gruas. Arsyen e gjithë veprimtarisë së tij e përmbledhi në një ide të vetme: -Lumturia është e mirë, vuajtja është e keqe.

er në lumturi, përse njeriu nuk duhet ta bëjë atë? Por çfarë do të mendonte Bentham për një gjë të tillë? Me utilitarizmin e tij ai ka menduar që, sa më pak vuajtje dhe sa më shumë të lumtur. Nuk ka thënë

dhimbjet që do të shkaktonin ato, janë të paimagjinueshme.

Nëse Kristina e mendon rastin me xhaxhain e saj të veçantë, gjithsecili do të kishte të drejtë që rastet e veta t'i men-



Sipas kësaj ideje, qëllimi i shoqërisë duhet të jetë: "Sa më pak vuajtjes dhe sa më shumë të lumtur. Sa më shumë lumturi, që vjen në botë si rezultat i përpjekjeve, aq më e nevojshme dhe më e mirë është ajo. Këtë parim themelor, Bentham e quajti utilitarizëm.

Parimi themelor, vuajtja është e keqe dhe lumturia është e mirë, duket shumë bindës.

Përse të mos përdoret në rastin e Xhaxha Thomait?! Ai nuk ka sjellë dhe as që ka ndërmend të sjellë kurrë lumturi në këtë botë. As për veten e tij dhe as për të tjerët. Edhe paratë e tij në bankë, nuk sjellin ndonjë të mirë për të tjerët. Është e mundur që dikush të ndryshojë diçka.

A nuk do të ishte më mirë që me paratë e tij të mjekoheshin fëmijët që vuajnë nga leuçemia apo sëmundje të tjera, për kurimin e të cilave u duhen shumë para? Paratë e një njeriu të lig, do t'i bënin ata të lumtur. Bentham ka të drejtë. Duhet shpërthyer arka e vjetër, ku mbahet e mbyllur lumturia e të tjerëve. Thomai duhet vrarë. Askush nuk do të derdhë asnjë pikë loti për vdekjen e tij. Përkundrazi. Të gjithë do të gëzohen. Do të gëzohen!?

Nëse e vret xhaxhain e vet, Kristina do të mund të ndihmonte disa fëmijë të sëmurë me paratë e tij. Xhaxhai është ligësia. Duke hequr këtë ligësi nga kjo botë, do të mund të bëhen disa të lumtur. Pra, kur ligësia është e mundshme për t'u kthyer

se sa më pak vuajtje, duke vrarë ata që i bëjnë të tjerët të vuajnë. Në asnjë rast ai nuk është shprehur se vuajtja pakësohet duke vrarë të tjerët. Kushdo qofshin ata.

Te gjithë dimë diçka për vrasjet dhe vdekjet e rreth 8 milion njerëzve në dhomat e gazit nga Hitleri. Është fare normale që të gjithë të pyesim se përse njerëzit e asaj kohe nuk e ndjenin për detyrë vrasjen e Hitlerit dhe t'i kursenin njerëzimit kaq shumë vuajtje dhe dhimbje?

Duke e argumentuar rastin sipas teorisë së Bentham, duhet menduar se një tiran që vret dhe mbyllet njerëzit e pafajshëm në dhomat e gazit, që rrezikon paqen në botë, duhet të vritet. Kjo, për arsyen se pesha e fatkeqësisë dhe vuajtjeve që sjell ai tek të tjerët, janë shumë më të mëdha se sa fatkeqësia e personit që i shkakton ato. Kështu është për kryeterroristin Bin Laden, Sadamin, Milosheviçin, Gadafin e të tjerë.

Por, nëse do të mendohej kështu edhe për Thomain, sigurisht që Bentham do të vdiste së qeshuri. Nëse do të pranohet vrasja e Thomait, askush nuk do të ishte në gjendje të thoshte se deri ku do të shkonte vrasja. Kush e di sa politikanë, mashtues, kriminelë, të sëmurë psikikë, sakatë etj., do të asgjësoheshin brenda natës, në krevat duke fjetur. Imagjinoni panikun që do të shpërthente në gjithë botën! Imagjinoni konfliktet e pafundme që do të sillnin vdekje të tilla! Vuajtjet dhe

donte të veçanta. Përse jo!? Kështu që do të kishim një vrasje masive dhe të përherëshme, botërore. Nëse gjithkush do ta gëzonte të drejtën e vrasjes, atëherë askush nuk do të ndjehej më i sigurtë. Nëse Kristina mendon se ka të drejtë ta vrasë xhaxha Thomain, kush mund ta sigurojë atë se dikush tjetër nuk paska të drejtë ta vrasë Kristinën? A mund ta mendojë ajo jetën e saj pa konflikte me të tjerët!?

Vrasja kurrë nuk është, as qetësi dhe as zgjidhje. Ajo është vetëm vuajtje, si në kohën e mendimit dhe pas kryerjes së kriminit. Vrasja është ferri i përjetshëm, para dhe pas vdekjes.

Vuajtja, edhe sipas Bentham, nuk pakësohet me vrasjen, qoftë dhe të atij që ta shkakton atë. Vrasja nuk zgjidh konflikte. Përkundrazi, ajo kthehet në reaksion zinxhir konfliktesh.

Morali dhe e drejta nuk janë çështje hamendjesh individësh. Ato janë shumë më tepër. Një të drejtë të përbashkët, askush nuk ka të drejtë ta shpërdorë, për interesat e veta, sado që të rrezikohen ato. Edhe për rastet ekstreme, shoqëria i ka gjetur dhe përcaktuar të drejtat.

Xhaxha Thomai duhet të vazhdojë të jetojë. Kristina duhet ta zbrazë "shiringën" e helmit.

LEKË IMERAJ
shkrimtar, përkthyes, publicist

Gazetari Gjini Kolë Musa

Gjini Kola Musa ka lindur me 15 qershor 1952, në fshatin Namavriq, të krahinës së Shalës, Dukagjin, i biri i Kole e Age Musa.

Prindërit e tij janë larguar nga fshati Namavriq në viti 1955. Fillimisht jemi vendosur në qytetin e Kukël të Lokalitetit Bushat.

Shkollimi dhe dija ishin pasioni i jetës. Me shumë dëshirë dhe pasion shërbeu në radhët e ushtrisë, Shkodrës, në lagjen "Tome Kola" përballë kishës s' Shënkollit. Me kalimin e viteve, vendosen në fshatin në armen e aviacionit dhe për një periudhë kohe komandant i Repartit 2203/b pranë detashmentit të Ministrisë së Mbrojtjes në Tiranë. Largohet nga Tirana dhe fillon punë në Brigadën e Vau Dejës me komandant brigade Kiço Mustaqin dhe shef i aparatit politik Ndue CUKELI,

Në regjimentin e helikopterëve nr. 3780 caktohet mekanik avioni në skuadriljen e dyte në helikopterin 6-43, me komandant skuadrilje aviatorin Et'hem Mehmeti dhe komandant ekuipazhi pilotin Mentor Ruga.

Gjini, jetën ushtarake e donte shumë edhe pse kritikohej si liberal e i pa disiplinuar, ndoshta mosha bënte të veten. Transferohet në Detashmentin e Ministrisë, aty e priti një ushtarak shumë autoritar, i cili quhej Milto Kosova.

Mbështetja maksimale nga Komandanti i Detashmentit, Gjeneral Milto Kosova ia rriti më shumë dëshirën dhe pasionin për uniformën ushtarake.

Gazetarin e ka pasur gjë të shenjta, por në sistemin moniste lufta ndaj tij ishte e pa mëshirshëm edhe pse ka filluar të shkruaja që në moshën 14 vjeçare, nuk u tërhoqe përpara njerëzve me një xheloz të sëmurë.

Shpejte u be i njohur në mediat e asaj kohe, shkruante në gazetën "Zëri i Popullit", "Bashkimi", "sporti", "Humori", "Zëri i Rinisë", "Luftëtari" dhe në revistën "10 korriku"

Gjini, tregon, se personi i pare, që i dha kuraja të shkruaja ishte Vebi Çanga, një njëri i dashur dhe kurajues për brezin e ri. Gazeta lokale "Jeta e Re", organ i komitetit të Partisë për Shkodrën tashmë, ishte dera e pare ku fillova shkrimet e mija për krahet gazetareve dhe bashkëpunëtorëve të kësaj gazete.

Lufta e klasave dhe duke më quajtur të huaj, me banim në Kukël rondonin mbi jetën time prej një adoleshenti, që kërkoi me çdo çmim të realizoja ëndrrat e mija.

Prindërit e mi, punonin në kooperativë, pagesa ishte e vogël, ne u shtuam shume, 8 fëmije, 4 djem dhe 4 vajza, vetëm me bukë thatë ishte e vështirë me i

rrite. Jam krenar për prindërit, që na linden dhe na rriten me plot dinjitet,

Për Gjini, vendlindja, fshati Namavriq ishte parajsja e botes, Breg Lumi i Shalës ishte emblema e dashurisë, aty tek daja im, i cili sot nuk jeton, Lazer Pali ishte vëllai i nanës, kishte plote daja, të gjithë bregalumasit e thërrisnin nipash, ah sa lumturohesha.

Jeta ushtarake ishte e shenjt për mua edhe pse nuk arrita atje ku ëndërroja, arsyet janë ekstreme, që kurrë nuk dua ti kujtoj, thekson Gjini, por rrethit shoqëror kudo që kame punuar, më kane vlerësuar. Gjithsesi pyll pa lisa të shtrembët nuk ka.

Me ardhjen e demokracisë, me votën e popullit, Gjini fitojë detyrën e sekretarit të këshillit të Komunës Bushat, komune nder më të mëdhatë në nivel vendi.

Demokracia për fatin e keqe, thotë Gjini, na zhgënjeu, intelektualët në të gjitha fushat e jetës i braktisi, vendin e tyre e zunë njerëz të pa afte dhe të korruptueshëm.

Megjithatë, në atë detyrë filloi punën për ti shërbyer me shpirt populli të lodhur dhe të rraskapitur, por klika e pushtetit në rrethe dhe deri në qendër krijuan rrethin korruptuar tepër të rrezikshëm. Lufta ndaj meje, thotë Gjini, fillon: "O në grupin e hajduteve ose larg pushtetit!" Deputete, që morën votën për ti shërbyer vendit, aq shpejt ju kthyen xhepit dhe rrethit mafioz të grabitjeve, dhe atëherë çfarë vinte për popullin?! Fondet e ndihmave u shpërdanin bandave të hajduteve, të cilët mbroheshin nga pushteti i asaj kohe.

Në këto kushte Gjini largohet nga atdheu dhe thekson, se ishte një goditje e rende për jetën time, do të fillonte gjithçka nga fillimi dhe në një vend të huaj. Pasi kalova detin me gomone i drejtohem Milanos në mëshirë të fatit dhe ndihmës së Zotit. Kame udhëtuar gjithë natën në dhe të huaje pa dite se ku do të vendosem! Mëngjesi më zbardhi në stacionin e trenit të Milanos. Ishte një mjegulle e dendur dhe të ftohtit ma presin pak besimin, por duke pyetur arrita në pjaca DUOMO dhe kur mbërrij atje përballë më shfaqet kisha madhështore, që në oborrin e sajë ishin plote emigrant, të pa numër, të cilët ëndërronin për një jete më të mirë. Takova shumë nga rrethi i Shkodrës, njoha shumë prej tyre, madje një pjesë më thërrisnin sekretar në atë mëngjes, duke menduar se jomë për ndonjë vizite pune, në Milano, por mjerisht isha një emigrant si gjithë të tjerët.

Gjini vijon rrëfimin e tij: Rrugëtimi në kërkim të një jete sa më të mirë do të vijonte, shkova në Francë, Luksemburg, Belgjike, Gjermani dhe Austri, por përfun-

dimisht sistemohem në Romë dhe fillojë jetën me plote probleme, pasi emri shqiptarë ishte i përbuzur nga autoritet policorë Italiane, një racizëm i pa shoq ne ato vite 1990 - 1995, për të ardhur viti famë keq i 1997, që Italianet po tmerroheshin me atë çka po ndodhte në Shqipëri.

Në atë vit famëkeq për Shqipërinë e shqiptaret, u arratisen nga Shqipëria qindra ushtarak të niveleve të ndryshme dhe deri pilot mësyn Italinë së bashku me avionët e tyre reaktiv dhe Helikopterë. Me një pjesë prej tyre pata rastin të takohem, tregon Gjini, me të cilët u shmalle, kujtuam vitet e shërbimit në radhët e ushtrisë Shqiptare, që tashmë ishte shpërberë plotësisht.

Gjini, në Rom fillon të bashkëpunojë me mediat shqiptare, duke përcjellë jetën e përditshme të emigracionit. Mori nismën të ngre median e vete private, si pamfletin "Një Dritare", me mision letrar-artistike, por pa u shkëputur tërësisht edhe nga politika.

Direkt, hapi Radion "MERGIMTARIN" dhe pa kaluar shumë kohë hapa edhe RTV "MERGIMTARI", që me emisionet dhe botimet fitoi një popullaritet të gjere, si edhe Titullin AKADEMIK.

Gjini, gjithë arritjet ja ka dedikuar vendlindjes, NANMAVRIQIT dhe mbare Dukagjinit, kësaj zone, që na lartëson kudo jemi ne Dukagjinasve, se jemi krenar prej nga vijmë dhe atij vendi i kemi borxh edhe jetën.

AH KOMUNIZËM

Ajo kohë e zezë vështirë të harrohet kohë e komunizmit, koha ma mizore. Sa shumë e kemi vuajtur ne shqiptarët atë kohë vetëm Zoti di ta tregoj.

Ah komunizëm, Ti farë e keqe të zgjuarve, të mirëve, ua shkurtove jetën. Sa intelektual vare në litar pushkatime, burgje dhe internime për të gjithë ata që ëndërronin lirinë.

Ah komunizëm, Ti bishë gjakatare besimin tek Zoti na hoqe duke shembur përdhe kisha dhe xhamia priftërinjtë dhe besimtarët në litar i vare i burgose qelive famë zeza i torturove, i pushkatove, po besimin tek Zoti kurrë s'ua hoqe.

Ah komunizëm, ç'të shkruaj për ty? Kujtoj bukën hibride me pak sheqer lyer

mjerimin, skamjen, varfërinë apo kohët e burgjeve dhe të torturave nga njerëzit e pashpirt që s'ngopeshin asnjëherë duke stërmunduar popullin tim... Kujtoj lotët e mjerimit të kohës së komunizmit.

BRUKSEL, me 1994

REFUGJATËVE KUDO NË BOTË

Lind o diell që ngroh globin shkëlqej moj han që ndriçon natën Refugjatët ëndërronjë fatin.

Kush ndër kampe e kush ndër burgje kush për rrugë tujë be shtegtim tujë lut Zotin plot dëshpërim Në qofsh kund Zot me na ndihmua

Kemi lënë shtëpi dhe atdhe kemi lanë vllazën edhe motra sa lot derdhin në ato vatra. Kemi lanë babë edhe nanë vështronjë rrugën në prag të derës një vështrim, vështrim i gjatë.

Refugjatët kudo në botë janë si zogu pa fole janë si fëmija rritur jetim që nuk din se kë ka prind.

BRUKSEL, me 1994)

VLLA VRASJE

Çfarë është kjo pushkë që diku ra Pushkë e keqe more vlla Kërcet pushka anë për anë writen të rinjtë si në kasaphanë.

A thua Zoti na ka dënua kurrë shqiptari mos me u gëzua? A asht nam nga perëndia apo nga robi vjen tradhtia?

Kastriot çohu nga varri merre me vete Anton Çetën me vu bese me mbledh kuvendin gjak mos ketë ma në Shqipni gjak që e solli '97-ta.

ROMË, me 1998

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
SADIK GURI

